

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Mbrojtja

Viti i 90-të i botimit
Qershor 2022/ Nr. 6

“Vlerat
euroatlantike,
destinacioni final i
shqiptarëve”

100 VJET
MARRËDHËNIE
DIPLOMATIKE
SHQIPËRI-SHBA

Përmbajtja

Numri 6

ANGAZHIMI

- 9** Kryeministri Edi Rama: Numrit më të lartë të turistëve do t'i përgjigjemi me plazhe më të pastra

TAKIMI

- 15** Gjeneralmajor Begaj: Shqipëria ka angazhuar gjithë instrumentet e saj në mbështetje të Ukrainës

TAKIMI

- 17** Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj merr pjesë në takimin e Komitetit të Aviacionit të NATO-s në Romë

SOCIALE

- 30** Korrupsioni vret, denigron, përbalt ndërgjegjen tënde! Ndal!

9 MAJI, DITA E EUROPËS

- 40** Europa, adresa ku na bashkon historia dhe përkatësia jonë shpirtërore

STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të Botimeve
& Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza GOLIKJA

Graphic Designer:
Afërdita HYSAJ

Redaktore/ korrektore:
Suela HODA



4 100 VJET SHQIPËRI-SHBA

Ministri i Mbrojtjes Peleshi:
Vlerat euroatlantike,
destinacioni final i shqiptarëve

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi mori pjesë në ceremoninë e zhvilluar për 100-vjetorin e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike mes Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara...



12 VIZITA

Gjeneralmajor Begaj: SHBA i jep Shqipërisë 17 milionë dollarë për ushtrinë

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, prof. asoc Bajram Begaj zhvilloi një vizitë zyrtare në Pentagon, ku u prit nga kryetari...



11 MODERNIZIMI

Raketa antitank "Javelin", në kuadër të modernizimit të FA-ve dhe plotësimit të objektivave ndaj NATO-s

Forcat e Armatosura të Shqipërisë do të kenë pjesë të tyre një nga sistemet më të mira raketore antitank "Javelin". Lajmi u konfirmua nga vetë ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi...



26 Intervistë

Kolonel Altin Gjetaj: QPR, qendra avangard e Forcave të Armatosura

Komandant Gjetaj, fillimisht ju uroj suksese në drejtimin e Qendrës së Personel-Rekrutimit, kësaj strukture të rëndësishme të Forcave të Armatosura të RSH...

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

Mbrojtja



Botues:

Qendra e Kulturës, Medias,
Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe
Botimeve të Mbrojtjes

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror
i Ministrisë së Mbrojtjes
Viti i 90-të i botimit
Nr. 6/ 2022

© Ministria e Mbrojtjes

Materialet e publikuara në këtë
revistë nuk mund të riprodhohen
elektronikisht apo fizikisht e të
përdoren për qëllime përfitimi, pa
marrë autorizim nga botuesit e saj.

**Revista mund të gjendet në formatin
elektronik (pdf) në adresën:**

[http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/
publikime/revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)





100 VJET marrëdhënie diplomatike Shqipëri-SHBA



**Ministri Peleshi: Vlerat
euroatlantike, destinacioni
final i shqiptarëve**

ER

R A H



mirënjohjen për mbështetjen që SHBA i ka dhënë vendit tonë në arritjet e mëdha veçanërisht për anëtarësimin e saj në NATO dhe pavarësinë e Kosovës.

Duke e vendosur fjalën e tij në kontekstin e situatës së krijuar në Ukrainë, ministri i Mbrojtjes u shpreh se: "ky 100-vjetor është një gur tjetër kilometrik shumë i rëndësishëm për të dy palët, në mënyrë të veçantë në një kohë kur themelet e sigurisë dhe të paqes në botë janë vënë në provë të vështirë për shkak të agresionit të egër dhe të pajustificuar të Rusisë ndaj popullit të pafajshëm të Ukrainës".

"Në këtë 100-vjetor të vendosjes së marrëdhënieve tona diplomatike, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Shqipëria janë më afër se kurrë. Padyshim që ndihemi shumë krenarë që përfaqësohemi me dinjitet në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara si 'bashkëpenëmbajtës' me vendin më të fuqishëm të globit, me vendin që për asnjë çast nuk reshti së mbrojturi interesin tonë kombëtar edhe në ditët më të errëta të historisë së shqiptarëve. Ndihe mi krenarë dhe mirënjohës

për vlerësimin që Shqipëria merr si një promovuese e palodhur e paqes dhe stabilitetit në rajonin e Ballkanit Perëndimor, përherë të brishtë ndaj influencave që tentojnë të përdorin etninë dhe fenë si elementë përçarës dhe destabilizues. Ne jemi të qartë dhe të hapur në qëndrimet tona dhe diplomacinë që promovojmë në rajon. Ballkani Perëndimor ka vetëm një destinacion: Bashkimin Europian dhe vlerat euroatlantike! E natyrisht, në këtë rrugë, inkurajues të palodhur kanë qenë dhe mbeten Shtetet e Bashkuara të Amerikës", -theksoi gjatë fjalës së tij, z. Peleshi.

Ministri i Mbrojtjes garantoj se Shqipëria do të punojë bashkë me aleatin strategjik në mënyrë që dekada e re të jetë dekada e konsolidimit të demokracisë, sundimit të ligjit dhe e mirëqenies së të gjithë shqiptarëve.

Po ashtu, ministri Peleshi garantoj se Shqipëria do të jetë gati të përmbushë detyrimet që i takojnë si vend anëtar i NATO-s në çdo kohë, në çdo vendim që merret për të garantuar jetën, lirinë dhe mirëqenien e qytetarëve, duke vijuar edhe angazhimin në misionet jashtë vendit si në: Irak, Afganistan, detin Egje, Bosnje, Kosovë, Letoni, Sudan i Jugut, etj.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi mori pjesë në ceremoninë e zhvilluar për 100-vjetorin e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike mes Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ku i pranishëm ishte edhe ish-sekretari amerikan i Shtetit Mike Pompeo. Ministri Peleshi shprehu



Komandanti Wolters, vizitë lamtumire në Shqipëri

Ministri Peleshi: Mirënjohje për kontributin e dhënë në modernizimin e FA-ve

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi priti në një takim lamtumire komandantin Suprem të Fuqive Aleate në Europë, gjeneral Tod Wolters. Pasi i uroi mirëseardhjen, ministri Peleshi e falënderoi gjeneralin Wolters për kontributin dhe përkushtimin e tij, jo vetëm gjatë periudhës 3-vjeçare si Komandant Suprem i Fuqive Aleate në Europë, por edhe për sakrificat dhe dedikimin, përgjatë gjithë karrierës së tij të spikatur 40-vjeçare, karrierë e mbyllur me sukses në detyrën ndoshta më të lartë për një ushtarak. Gjithashtu, zoti Peleshi vuri në dukje dhe e përgëzoi gjeneralin Wolters për leadershipin e treguar gjatë kësaj periudhe të trazuar, mes pasigurive në të cilat po kalon kontinenti ynë, duke dëshmuar edhe një herë solidaritetin, unitetin dhe vendosmërinë e Aleancës për të mbrojtur çdo centimetër të territorit të saj, vlerat demokratike dhe lirinë e popujve të saj, të fituara nëpërmjet përpjekjeve të shumëfishta.

Më tej, ministri Peleshi u ndal te roli që gjeneral Wolters ka luajtur në mbështetje të Forcave të Armatosura të RSH, në kuadër të modernizimit të tyre, rritjes së kapaciteteve operacionale dhe ndërveprueshmërisë. Shembulli konkret i kësaj mbështetjeje dhe vëmendjeje, ishte zhvillimi në vendin tonë i stërvitjes "Defender Europe 21", të cilën gjeneral Wolters pati rastin ta inspektojë nga afër, por dhe për zhvillimin e projektit të NATO-s për modernizimin e Bazës Ajrore të Kuçovës.



Forcat e Armatosura të Shqipërisë do të kenë pjesë të tyre një nga sistemet më të mira raketore antitank "Javelin". Lajmi u konfirmua nga vetë ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi: "Është në kuadrin e modernizimit të FA-së, rritjes së kapaciteteve tona, plotësimi të objektivave që Shqipëria ka në raport me NATO-n. Sistemi raketor antitank "Javelin" po prodhohet nga kompania amerikane, më e madhja në botë e industrisë ushtarake, "Lockheed Martin", dhe ne kemi bërë porosinë tonë aty si pjesë e rrugëtimit tonë për forcimin e FA-së, modernizimit, rritjes së sigurisë dhe mbrojtjes territoriale të vendit tonë. Nuk është se ka ndonjë kërcënim konkret, që mos të krijojmë panik, ne jemi një vend në NATO, ne kemi zgjidhur çështjen e sigurisë kombëtare, jemi të mbrojtur, sepse na mbronneni 5 i traktatit të NATO-s, sipas të cilit hapësira e NATO-s është e paprekshme, por ne natyrisht do të vazhdojmë të ndjekim ritmin e NATO-s për t'u forcuar si pjesë e një aleance defensive", -u shpreh ministri Peleshi.



Shqipëria do të pajiset me një nga sistemet më të mira raketore antitank "Javelin"

Ministri Peleshi: Raketa antitank "Javelin", në kuadër të modernizimit të FA-ve dhe plotësimit të objektivave ndaj NATO-s

Veç këtij sistemi, sipas ministrit të Mbrojtjes, do të ketë edhe blerje të tjera apo donacione nga partneri strategjik i Shqipërisë, SHBA apo nga partnerë të tjerë në NATO.

Sipas ministrit të Mbrojtjes: "Sado që NATO është e fuqishme, nuk është kërcënim për botën, nuk është kërcënim për Rusinë, nuk është kërcënim për rajonin, sepse është një forcë jo ofensive, nuk ka qëllim të sulmujë, por ka për qëllim të garantojë mbrojtje. Forcimi i NATO-s do të thotë dekurajim i fuqive të

tjera, shpeshherë jo kaq pozitive, dhe rivalët tanë të vlerave politike, t'i shkurajojë në përpjekjet për t'u kthyer në politika të shekujve të kaluar, ndarjes së hartave apo ligjit që bën më i madhi në krahasim me të voglin".

I pyetur në lidhje me kërkesën për anëtarësim të Suedisë dhe Finlandës në NATO, ministri i Mbrojtjes tha se vendi ynë do të përkrahë linjën e Aleancës. "Ne jemi një aleat i vogël në NATO, por që gjithmonë jemi dhe do të jemi në linjë me partnerët

tanë strategjikë, SHBA-të, të cilët janë dhe orientuesit e linjës që ne i përkrahim në raport me zhvillimet e NATO-s. Një nga politikat e NATO-s që ne e mbështesim është politika e "dyerve të hapura", kështu që Suedia dhe Finlanda janë dy shtete sovranë të pavarura me standarde të larta politike dhe ligjore, por dhe standarde ushtarake", - theksoi ministri i Mbrojtjes. Sipas tij, Shqipërisë dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor u intereson të promovojnë sa më shumë politikën e "dyerve të hapura", në mënyrë që të shtohet ritmi i negoci-



atave të anëtarësimit të rajonit, jo vetëm si një rrugë për forcimin e demokracisë, shtetit ligjor e prosperitetit, por edhe të sigurisë që pas 24 shkurtit është shtuar në të gjitha proceset.

"Një Ballkan perëndimor i integruar plotësisht në BE dhe NATO, përfshirë këtu natyrisht edhe Kosovën edhe Bosnjën, edhe vende të tjera, do të thotë një siguri më e lartë për rajonin tonë, i cili për hir të së vërtetës është i brishtë dhe brishtësia vjen pikë së pari se proceset tona integruuese dhe politika e "dyerve të hapura" nuk ka gjetur zbatimin në rajonin tonë.

Pra, ne jemi mbështetës të zjarrtë të politikës së hapur të NATO-s dhe BE-së edhe për shkaqet tona të brendshme apo rajonale", - theksoi ministri Peleshi.

Mbahet takimi i Grupit të Kontaktit për Ukrainën, që drejtohet nga SHBA

Ministri Peleshi: Mbështetja e pakursyer e Shqipërisë në dimensionin politiko - diplomatik, humanitar dhe ushtarak

Ministria e Mbrojtjes konfirmon edhe një herë mbështetjen dhe angazhimin e Shqipërisë në dimensionin politiko-diplomatik, humanitar dhe atë praktik ushtarak.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi mori pjesë në takimin e Grupit të Kontaktit për Ukrainën, i cili u mbajt nëpërmjet video-konferencës.

Takimi u zhvillua nën drejtimin e sekretarit të Mbrojtjes së SHBA-së, z. Lloyd Austin dhe është në vijimësi të takimit që u mbajt në Bazën Ajrore të Ramstein, në Gjermani, më 26 prill 2022.

Ashtu si në takimin e parë të datës 26 prill edhe në këtë takim, morën pjesë ministra të Mbrojtjes dhe përfaqësues nga afro 44 vende të ndryshme. Pjesëmarrësit u përditësuan mbi situatën aktuale në Ukrainë, progresin e deritanishëm të donacioneve si dhe koordinimet përkatëse për sa i përket përmirësimit

të kapaciteteve mbrojtëse të Ukrainës.

Ministrat dhe organizatorët nënvizuan rëndësinë që mbartin takime të kësaj natyre, duke ripërsëritur faktin se vetëm nëpërmjet konsultimeve të këtyre niveleve, punës së përditshme dhe koordinimeve të vazhdueshme, do të arrijmë të mbështesim Ukrainën sa dhe si duhet, në këtë përpjekje ekzistenciale të tyre.

Ministria e Mbrojtjes konfirmon edhe një herë mbështetjen dhe angazhimin e Shqipërisë në dimensionin politiko-diplomatik, humanitar dhe atë praktik ushtarak.

Takimi i radhës i Grupit të Kontaktit për Ukrainën u ra dakord të mbahet në mes të muajit qershor, kur pritet edhe një mbledhje e ministrave të Mbrojtjes të NATO-s.



Kryeministri Edi Rama: Numrit më të lartë të turistëve do t'i përgjigjemi me plazhe më të pastra

Plani i Pastrimit Kombëtar për t'i dhënë dorën e fundit pastrimit të bregdetit përpara datës 1 qershor edhe me ndihmën e forcave të ushtrisë u ndoq nga kryeministri Edi Rama i shoqëruar nga ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi, zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu dhe ministrja e Kulturës Mirela Kumbaro. Kryeministri Rama ndoqi nga afër momente nga aksioni i pastrimit në territor. Rama siguroi se: "numrit më të lartë të turistëve do t'i përgjigjemi me plazhe më të pastra".

"Besoj se ky do të jetë sezoni më i pastër, edhe për shkak të punës së jashtëzakonshme që është bërë edhe për shkak të suportit financiar që është vendosur për t'i ardhur në ndihmë bashkive bregdetare, të cilat përjetojnë në sezonin turistik shumëfishimin e popullsisë dhe një ngarkesë ekstra që nuk përballohet dot me tarifat normale që kanë", -u shpreh Rama.

Kryeministri theksoi se: "është thelbësore që të gjithë të marrin pjesë në këtë përpjekje, ku nëse nga ana e bashkisë ka përpjekje për ta pastruar, të tjerët duhet të përpiqen për të mos ndotur".

"Ky është elementi i parë i abetares së patriotizmit, të mos ndotim shtëpinë tonë. Do të vazhdojmë t'i rrimë mbi kokë kësaj pune, derisa të mbyllet gjithë sezoni, i cili me të gjitha gjasat do të jetë edhe sezoni me fluksin më të madh dhe me konsumin më të madh", -tha ai.

Ministrja Kumbaro u ndal te puna e madhe që është bërë gjatë këtyre 6 muajve. Sipas saj, sfidë mbetet ndryshimi i sjelljes së qytetarëve sepse, siç tha ajo: "ne i pastrojmë dhe ata kthehen prapë dhe ndotin ambientin". "Sfida më e madhe është puna që na duhet



të bëjmë me ndryshimin e mentalitetit. Kjo është beteja e këtij mandati", -tha ministrja.

Nga ana e tij, ministri Peleshi theksoi se në gjithë zonën bregdetare por edhe liqenore janë angazhuar 750 trupa. "Kemi forca të shumta për të krijuar një dorë të fundit të pastrimit të territorit", -tha ai.

Për të mundur një Shqipëri të pastër e dinjitoze u ndërmor Plani Kombëtar i Pastrimit, i cili nisi më 7 nëntor 2021 në Vlorë dhe ka përfshirë të gjithë territorin e vendit nga veriu deri në jug.

Plani i pastrimit ka vijuar pa u ndalur për muaj me radhë në çdo cep të territorit, sepse nuk është një aksion por një operacion sistematik e i gjatë, të cilit i duhet shkuar deri në fund.

Ndonëse sezoni turistik nisi zyrtarisht në maj, puna ka filluar që në tetor në një bashkëpunim të ngushtë midis instancave bashkake, ministrive, subjekteve private dhe qytetarëve.

"Në Durrës, ku vijon Plani i

Pastrimit Kombëtar për t'i dhënë dorën fundit pastrimit të bregdetit përpara datës 1 qershor edhe me ndihmën e forcave të ushtrisë, numrit më të lartë të turistëve i përgjigjemi me plazhe më të pastra", -shkroi gjithashtu ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi në profilin e tij në rrjetin social. "Të bashkuar jo të ndarë", -thekson ai.

Zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, tha për mediat se: "Forcat e Armatosura janë të angazhuara në maksimum në këtë aksion kombëtar ku po marrin pjesë për të mundur një Shqipëri të pastër dhe dinjitoze, në bashkëpunim shumë të ngushtë me të gjithë strukturat e pushtetit vendor (prefekturat e bashkitë), në zonat e përcaktuara për pastrim. Aktualisht ato janë të dislokuara përgjatë gjithë bregdetit dhe kryesisht në spotet më kyçe të vendit, duke marrë në konsideratë sezonin turistik dhe fluksin e pritshëm të pushuesve vendas e të huaj", -tha ajo.



Plan për bazë detare të NATO-s në Shqipëri

Kryeministri Edi Rama i dorëzoi në Tiranë, medaljen "Ylli i Madh i Mirënjohjes Publike", Komandantit të Komandës Operacionale të NATO-s, gjeneral Tod Daniel Wolters.

Rama i dorëzoi medaljen e lartë gjeneralit Wolters me motivacionin: "Me mirënjohjen e thellë për vizionin, kontributin dhe bashkëpunimin me Forcat e Armatosura shqiptare, si dhe për mbështetjen e rolit të Shqipërisë në ruajtjen e paqes e sigurisë rajonale".

Në fjalën e tij, Kryeministri Rama tha: "Gjenerali ka një vend të posaçëm, nuk po e them këtë për shkak të rrethanave apo rasti e do se duhet t'i them ca fjalë. Ishim ne që donim

këtë, nuk na u kërkua ta bënim këtë gjë, ndonjëherë na kërkohet siguri, ndonjëherë duam ne diçka, dhe donim që të shprehim përgëzimet tona posaçërisht gjeneralit Wolters, si një prej personave më të shquar që ka përfaqësuar në më të mirën e vet këtë marrëdhënie".

"Gjenerali Wolters veçanërisht, jo vetëm ka qenë mbështetës, por edhe i prirur të tregojë me vepra e jo me fjalë që e ka për zemër këtë marrëdhënie dhe fjala 'për zemër' është diçka që e vlerësoj shumë, sidomos në marrëdhëniet ndërkombëtare të këtij vendi që në fund të fundit kanë të bëjnë me njerëzit. Forcat e Armatosura kurrë nuk do të harrojnë se ishte pikë së pari

gjenerali Wolters që qysh prej ditës së parë mbështeti transformimin e bazës ajrore të Kuçovës në një bazë taktike të NATO-s, si dhe mbështeti që prej ditës së parë Shqipërinë si një prej vendeve pritëse të stërvitjes "Defender Europe", -theksoi Rama.

Kreu i qeverisë u shpreh se: "ishte gjenerali Wolters, që përkrahu dhe mbështeti qysh prej ditës së parë që Shqipëria të kishte selinë e forcave të speciale të komandës së SHBA-së në Europë".

Më tej, Rama tha se: "është hera e parë kjo që personi që nderojmë sot është 'Gjeneral', për mua nuk është hera e parë, por ndoshta e fundit që kam privilegjin të dekoroj një gjeneral. Gjenerali u tregua shumë i



Kryeministri Rama nderon me “Yllin e Madh të Mirënjohjes Publike”, gjeneralin e NATO-s

sjellshëm duke më thënë që ka marrë çdo yll e medalje që shteti amerikan mund t'i jepte. Shtimi i një tjetër embleme në uniformën e tij është një privilegj i jashtëzakonshëm. Ky është një moment për të kremtuar miqësinë e çmuar me aleancën më të çmuar që ky vend ka pasur fatin të ketë që është miqësia dhe aleanca me SHBA-të”.

“Miqte tanë europianë ndiejnë një lloj kureshtie se si ndodh që Shqipëria e shqiptarët janë pro-amerikanë. Jam i sigurt, që nëse disa prej tyre nuk janë familjarizuar me historinë tonë mund t'u dukemi budallenj. Por jo, ne mund të jemi gjithçka, por nuk jemi budallenj. Ne jemi këtu në këtë

pjesë historie të lidhur kaq fort me këtë aleat e këtë mik, falë edhe një pjese tjetër të historisë që ndërpreu këtë marrëdhënie, e cila këtë vit shënon 100-vjetorin e saj. Është 100-vjetori i marrëdhënieve shqiptaro-amerikane që e patën pikënisjen 100 vjet më parë, si njohje zyrtare në nivel marrëdhënie diplomatike, por që u ndeshën me gjysmë shekulli heshtje nga pala amerikane dhe gjysmë shekull zhurmë të stërmadhe nga ana jonë.

Pasi, duke qenë krejtësisht e izoluar dhe që u shndërrua gati në “Korenë e Veriut” të Europës asokohe, ne e nisëm atje ku e lamë në vitin 1991 dhe tashmë është ven-

dosur një gur themeli i ri, ku ne mund të kremtojmë raportin më të thellë e të frytshëm, raportin mes SHBA-ve dhe Shqipërisë”, -nënvizoi Rama.

“Ndoshta Forcat e Armatosura janë shprehja më e mirë e rrugëtimit tonë për të mësuar, shoqëruar, nga miqtë e aleatët amerikanë, brenda NATO-s dhe në nivel dypalësh. Nëse sot Forcat tona të Armatosura kanë shkuar në një nivel që edhe ata më optimistët nuk do të kishin mundur ta përfaqësonin 10, 20 apo 30 vjet më parë, kjo ka ndodhur falë miqve e aleatëve tanë amerikanë”, -u shpreh kreu i qeverisë.

Nga ana tjetër, -vijoi Rama, -nëse kemi qenë në gjendje të kuptojmë ngadalë, por me vendosmëri se kemi potencial për të shfaqur në aleancë së bashku me të gjithë nxitjen e shtysën e saj për të luftuar për atë që është e drejtë, kjo është së pari e mbi të gjitha, rrjedhojë e inkurajimit, fuqisë dhe solidaritetit që kemi pasur mundësi të perceptojmë nga miqtë dhe aleatët tanë amerikanë.

Kryeministri Rama tha se: “kemi disa ide të mira, dhe ajo që është më rëndësi, kemi disa miq të mirë dhe jemi shumë besimplotë që mund të gjejmë vendin tonë për të qenë vlerë e shtuar në këtë aleancë”.

“E lashë për këtë moment që t'i them Gjeneralit që nesër do të kemi mundësi t'i tregojmë disa prej ideve dhe në këto kohë mjaft specifike, mjaft të rrezikshme ai do të konsiderojë, ndoshta nuk është ide e keqe, për të pasur një bazë detare të fjalës së fundit të NATO-s në Shqipëri.

Na takon t'i paraqesim projektin atij dhe t'i tregojmë për çfarë kemi punuar dhe më pas ai sërish qysh prej fillimit do të jetë avokati dhe mbështetësi i kësaj ideje”, -tha Rama. Duke iu referuar luftës në Ukrainë, kryeministri Rama deklaroi se: “jemi radhitur në anën e duhur të historisë dhe jemi qysh kemi qenë që në krye të herës, të pozicionuar krah aleancës për të qenë kudo e kurdo është nevoja, në momentin e duhur në vendin e duhur për të luftuar çdo forcë që kërcënon jetesën tonë, botën së cilës i besojmë, të ardhmen e brezave që vijnë”.



Gjeneralmajor Begaj: SHBA i jep Shqipërisë 17 milionë dollarë për ushtrinë

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, prof. asoc Bajram Begaj zhvilloi një vizitë zyrtare në Pentagon, ku u prit nga kryetari i Shefave të Shtabeve të Bashkuara të SHBA-së gjeneral Mark A. Milley si dhe

shefi i Shtabit të Forcave Tokësore gjeneral James C. McConville. Gjeneral Milley pasi i uroi mirëseardhjen në Pentagon, gjeneralmajor Begajt, u shpreh se SHBA vlerësojnë maksimalisht rolin dhe kontributin e Shqipërisë si partner strategjik dhe anëtare e denjë e NATO-s. Gjeneral Milley theksoi se,

solidariteti dhe kohezioni që Shqipëria ka treguar në të gjitha vendimarrjet e NATO-s, si dhe kontributi aktiv dhe pjesëmarrja në misione dhe operacione të NATO-s dhe Kombeve të Bashkuara e bëjnë Shqipërinë një partner strategjik të rëndësishëm për SHBA-të.



Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj, vizitë zyrtare në Uashington, SHBA

Në vijim gjeneral Milley falënderoi Shqipërinë për kontributin që ka dhënë dhe po jep për Ukrainën si në planin politiko - diplomatik, ashtu edhe lehtësimin e procedurave për pritjen e refugjatëve dhe ndihmat ushtarake.

Gjeneralmajor Begaj falënderoi gjeneral

Milley-in për ftesën dhe zhvillimin e këtij takimi në këtë kohë ku siguria në Europë është e kërcënuar nga agresioni rus ndaj Ukrainës.

Gjeneralmajor Begaj bëri me dije se takimi ndërmjet kryetarit të Shefave të Shtabeve të Bashkuara të SHBA dhe shefit të Shtabit të

Përgjithshëm të FARSH zhvillohet për herë të parë në historinë e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve dhe mbart vlera historike. Vizita është produkt i bashkëpunimit të shkëlqyer ndërmjet dy vendeve dhe forcave tona të armatosura dhe Shqipëria është krenare për këtë partneritet strategjik.

Gjeneralmajor Begaj vlerësoi maksimalisht mbështetjen e vazhdueshme dhe ndihmën që SHBA ka dhënë dhe po jep për Shqipërinë dhe FARSH, për transformimin, modernizmin, trajnimin, edukimin dhe rritjen e kapaciteteve ushtarake. Në vijim të takimit u diskutua për një sërë çështjesh me interes të përbashkët.

Ndërkohë në takimin me gjeneral McConville diskutimi u fokusua në mbështetjen që SHBA-të po japin me trajnues dhe këshillues ushtarak (SFAB), asistencë e SHBA-së në sektorin e Sigurisë dhe Mbrojtjes, roli i Shqipërisë si vend pritës për stërvitjet dhe trajnimet në shkallë të gjerë si dhe kontributet në mbështetje për operacionet e NATO-s.

Gjatë vizitës në Pentagon, gjeneralmajor Begaj bëri nderime dhe vendosi një kurorë tek Memoriali i Ushtarit të Panjohur, në varrezat kombëtare të SHBA-së, në Arlington pranë Washingtonit.

Ndërkohë, në fund të vizitës gjeneralmajor Begaj u intervistua nga Zëri Amerikës mbi takimin me Shefin e Shefave të Shtabit të Bashkuar të ushtrisë amerikane, gjeneralin Milley, ku gjeneralmajor Begaj tregoi entuziazmin për bashkëpunimin 30-vjeçar me aleatin tonë strategjik NATO, si dhe programet e modernizimit, të cilat kanë qenë në bashkëpunim me Zyrën Amerikane të Bashkëpunimit. I pyetur mbi nisma diplomatike por edhe nga ana ushtarake ndaj Ukrainës, gjeneralmajor Begaj tha se: "qeveria shqiptare ka shprehur gatishmërinë për të mbajtur refugjatët ukrainas dhe ka



dhënë ndihma humanitare të llojeve të ndryshme. Në planin ushtarak kjo mbështetje është realizuar përmes donacioneve të bëra nga qeveria shqiptare, të cilat janë lloje të ndryshme municionesh të cilat ne i kemi pasur në përdorim dhe stok në depot tona të forcave të armatosura”.

I pyetur mbi fondet që japin Shtetet e Bashkuara lidhur me Ukrainën dhe lidhur me sigurinë se ku konsiston kjo ndihmë nga Shtetet e Bashkuara për Shqipërinë, shefi i shtabit të FA-së, gjeneralmajor Begaj do shtonte se: “ne kemi një zyrë bashkëpunimi ushtarak me Shtetet e Bashkuara, e cila gjendet në Ministrinë e Mbrojtjes shqiptare dhe kjo zyrë koordinon të gjitha buxhetet, të cilat jepen nga shteti amerikan për të ndihmuar forcat e armatosura shqiptare. Këto buxhete ndahen në dy kategori. Një buxhet janë grantet

të cilat janë falas, për të rritur fuqinë mbrojtëse të vendit dhe një kategori tjetër, e cila është me buxhete të përbashkëta, të cilat ndihmojnë në fuqizimin e kapaciteteve tona mbrojtëse. Dhe këtë radhë shteti amerikan ka akorduar një buxhet grant prej 17 milionë dollarësh për të rritur fuqinë mbrojtëse të forcave të armatosura dhe për të rritur kapacitetet mbrojtëse. E theksoj që çdo buxhet i modernizimit të forcave të armatosura shqiptare, shkon për të rritur aftësitë tona mbrojtëse. Ne nuk kemi asnjë synim për agresion apo për t’i shpallur luftë dikujt. Ne jemi thjesht në atë çfarë kërkonte NATO si aleancë, që të bëjmë mbrojtje dhe shkurajim për çdo armik apo për çdo kundërshtar.”

Me interes ishte dhe përgjigja ndaj pyetjes mbi një nga kontratat e fundit të qeverisë amerikane, që gjithashtu përfshin Shqipërinë, siç

është pajisja me sisteme raketash “Javelin”, për të cilën gjeneral Begaj do shuante kureshtjen se: “Shqipëria do të marrë nga kompania “Lockheed Martin” një sasi me raketa kundërajrore të tipit “Javelin”, të cilat do të rrisin fuqinë tonë mbrojtëse kundërajrore. Siç e përmenda dhe më parë ky lloj furnizimi me këto produkte ushtarake do të rrisë fuqinë mbrojtëse të vendit dhe asnjëherë nuk do të jetë për qëllime të tjera, kështu që do të jetë vetëm për qëllime mbrojtëse dhe si kapacitete që mund të përdoren kudo dhe kurdoherë që do të kërkojë aleanca.”

Mbi situatën që është krijuar në Europë, dhe se si e ka ndryshuar mënyrën se si përgatiten anëtarët e ushtrisë shqiptare, jo vetëm nga ana ushtarake, fizike, por edhe moralisht, psikologjikisht, gjeneral Begaj do të shprehë se: “situata e cila ndodhi në Ukrainë, është një situatë e cila është vlerësuar realisht nga forcat e armatosura shqiptare. Jemi të fokusuar në rritjen e përgjegjshmërisë së forcave të armatosura shqiptare, për të bërë detyrën sa më mirë, për t’u përkushtuar sa më mirë dhe për të krijuar ato kapacitete operacionale që nevojiten në rastet e një ndodhie të tillë. Shpresojmë që Ballkani Perëndimor, pavarësisht se është një situatë e vlerësuar e qetë, por është një rajon që është i brishtë dhe ne duhet të jemi shumë mirë të fokusuar. Dhe për këtë forcat e armatosura dhe shteti shqiptar e bëjnë detyrën shumë mirë, është eksportues i paqes. Ne kemi kontribuar në operacione dhe misione të ndryshme të aleancës dhe në Kosovë, në KFOR ne kemi trupat tona të cilat janë atje duke marrë pjesë në misione çdo gjashtë muaj dhe kontributet tona në NATO, jo vetëm në KFOR janë të mirëpritura nga NATO.”

SHEFI I SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË FARSH, GJENERALMAJOR PROF. ASOC. BAJRAM BEGAJ MORI PJESE NË TAKIMIN E KOMITETIT USHTARAK TË NATO-S

Gjeneralmajor Begaj: Shqipëria ka angazhuar instrumentet e saj politikë, diplomatikë dhe ushtarakë për të mbështetur Ukrainën

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, mori pjesë në Takimin e 187-të të Komitetit Ushtarak të NATO-s, në Bruksel, Belgjikë.

Takimi i Komitetit Ushtarak u hap nga kryetari i Komitetit Ushtarak, admiral Rob Bauer, i cili theksoi se NATO është aleanca më e suksesshme në histori, së pari për aftësinë për të qenë të bashkuar, dhe së dyti për aftësinë e saj për të ndryshuar. Ndërkohë, Sekretari i Përgjithshëm, z. Jens Stoltenberg, në fjalën e tij evidentoi ndryshimin e mjedisit të sigurisë, si pasojë e luftës brutale dhe të pprovokuar të Rusisë në Ukrainë, duke e përshkruar atë si mjaft të rrezikshme dhe të paprecedentë për sigurinë Euroatlantike. "Presidenti Putin po dështon në arritjen e objektivave strategjikë. Ukraina po reziston, NATO mbetet e fortë dhe uniteti transatlantik është solid" -u shpreh sekretari Stoltenberg. Takimi vijoi më tej me sesionet kushtuar luftës në Ukrainë; partnerët Finlandë dhe Suedi; vlerësimi operacional i komandantit Suprem të Aleatëve për Europën, gjeneral Tod Wolters dhe vlerësimi i Komandantit Suprem të Aleatëve për Transformimin, gjeneral Philippe Lavigne mbi konceptin



e ardhshëm të Zhvillimit të Luftës si dhe Udhëzimin Politik 23, si dhe situata në rajonin indo-paqësor dhe roli i Australisë, Japonisë, Zelandës së Re dhe Republikës së Koresë. Ndërkohë, në seancën e fundit u zhvillua takim privat midis shefave të Mbrojtjes për të shkëmbyer mendime të hapura për çështje strategjike.

Gjeneralmajor Begaj në ndërhyrjen e tij theksoi qëndrimin e Shqipërisë kundër agresionit rus ndaj Ukrainës dhe mbështetjen që Shqipëria ka dhënë dhe vijon të japë. Gjeneralmajor Begaj i bëri me dije Komitetit Ushtarak se: "Shqipëria në koor-

dinim të ngushtë me aleatët ka angazhuar instrumentet e saj politikë, diplomatikë dhe ushtarakë për të mbështetur Ukrainën. Ne kemi dhënë ndihmë në materiale luftarake dhe humanitare për Ukrainën dhe aktualisht po planifikojmë të dërgojmë një sasi tjetër donacionesh. Komiteti Ushtarak është përgjegjës për këshillimin e autoriteteve politike të NATO-s mbi masat që konsiderohen të nevojshme për parandalimin dhe mbrojtjen e përbashkët të territorit të NATO-s, si dhe për zbatimin e vendimeve në lidhje me operacionet dhe misionet e NATO-s."



Gjeneralmajor prof. asoc. Begaj pret në takim komandantin e TF-Letoni, kolonel Cauden

Gjeneralmajor Begaj: Falënderimet tona për mbështetjen e vazhdueshme ndaj trupave shqiptare, pjesë e grup-batalionit, kontributi i Shqipërisë do të vijojë edhe në të ardhmen

“Pas agresionit të paprecedentë dhe të pajustificuar që Rusia ka ndërmarrë në Ukrainë së fundmi, ne jemi më të bindur se kurrë se prezenca e përparuar e NATO-s në kufirin lindor të saj, nuk është thjesht një opsion, por një domosdoshmëri për të garantuar sigurinë e aleatëve”, - tha gjeneralmajor Begaj në fjalën e tij.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj priti në një takim komandantin e Task-Forcës (TF) - Letoni, kolonel Jean-Francois Cauden. Në fjalën e tij në takim, gjeneralmajor Begaj vlerësoi rolin e komandës së TF-Letoni si pjesë e masave të sigurisë së NATO-s me prezencë të përparuar përgjatë kufirit lindor të Aleancës. “Pas agresionit të paprecedentë dhe të pajustificuar që Rusia ka ndërmarrë në Ukrainë së fundmi, ne jemi më të bindur se kurrë se prezenca e përparuar e NATO-s në kufirin lindor të saj, nuk është thjesht një opsion, por një domosdoshmëri për të garantuar sigurinë e aleatëve”, - u shpreh ndër të tjera gjeneralmajor Begaj në fjalën e tij. Gjithashtu, gjeneralmajor Begaj falënderoi kolonel Cauden dhe zinxhirin e komandimit të

grup-batalionit të Përparuar të NATO-s të dislokuar në Letoni, për mbështetjen e vazhdueshme që ka dhënë për trupat shqiptare pjesë e grup-batalionit, duke e garantuar atë se kontributi i Shqipërisë do të vijojë edhe në të ardhmen. Nga ana e tij, komandanti i TF-Letoni, kolonel Cauden vlerësoi rolin dhe kontributin e Shqipërisë në sigurinë e kufirit lindor të Aleancës, si dhe theksoi profesionalizmin dhe përkushtimin e treguar nga ushtarakët shqiptarë pjesëmarrës në mision në Letoni. Komanda e Task-Force-Letoni ushtron komandim-kontrollin e trupave kanadeze pjesë e grup-batalionit të përparuar të NATO-s nën drejtimin kanadez në Letoni, në të cilin Shqipëria kontribuon që prej vitit 2017 me një togë EOD. Vizita e komandantit të “TF-Letoni” në Shqipëri vijoi me takime pune në Shtabin e Përgjithshëm dhe Komandën Mbështetëse.



Takimi i Komitetit të Aviacionit të NATO-s

Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj merr pjesë në takimin e Komitetit të Aviacionit të NATO-s në Romë

U zhvillua në Romë Takimi i Komitetit të Aviacionit të NATO-s me përfaqësues të vendeve anëtare dhe partnere të NATO-s, si dhe organizata ndërkombëtare dhe institucione të tjera të rëndësishme civile dhe ushtarake që operojnë në sektorin e aviacionit.

Takimi u kryesua nga Dr. Giorgio Cioni, drejtor i Armatimeve dhe Kapaciteteve të Hapësirës Ajrore në Divizionin e Investimeve të Mbrojtjes së NATO-s. Takimi u zhvillua vetëm disa javë përpara Samitit të ardhshëm të NATO-s në Madrid në fund të qershorit. Mandati i Komitetit të Aviacionit është të mbështesë përpjekjet e Aleancës për të vazhduar përshtatjen ndaj skenarëve të sigurisë që ndryshojnë me shpejtësi në një hapësirë ajrore gjithnjë e më komplekse dhe të ndërlikur. Në takimin e Komitetit të Aviacionit të NATO-s, delegacioni shqiptar u përfaqësua nga drejtori i Autoritetit të Aviacionit Civil z. Maksim Et'hemaj dhe komandanti i Forcës Ajrore gjeneral brigade Ylli Pulaj.

Takimi hapí perspektiva të reja për bashkëpunimin e ardhshëm civilo-ushtarak në sektorin e aviacionit, si dhe u diskutuan pikëpamje të rëndësishme për përballimin e sfidave të reja dhe zgjerimin e këtij bashkëpunimi shumëpalësh për zgjidhjen e tyre.

Presidenti i Komitetit të Aviacionit, dr. Cioni në fjalën e tij theksoi se: "Mbrojtja dhe aftësitë parandaluese të NATO-s mbështeten nga roli i aviacionit. Kjo kërkon një qasje gjithëpërf-



shirëse, të përkushtuar dhe kolektive midis sferës ushtarake dhe civile, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar. Përveç kësaj, Komiteti i Aviacionit është forumi ku vendet anëtare, partnerë dhe organizatat ndërkombëtare ndërveprojnë në kuadër të misioneve, operacioneve, stërvitjeve dhe trajnimeve të NATO-s".

Në fjalën përshëndetëse shefi i Shtabit të Forcave Ajrore Italiane, gjenerali i Skuadrës Ajrore Luca Goretti, vlerësoi rëndësinë e madhe që ka ky takim duke theksuar se: "Në skenarin e paqëndrueshmërisë dhe sfidave për vendet anëtare dhe partnerët e NATO-s, roli, detyrat dhe misionet e kryera nga Forcat Ajrore të Aleancës janë sot edhe më të domosdoshme dhe urgjente. Komponenti Ajror përfaqëson një nga aftësitë themelore të Aleancës". Ai theksoi rëndësinë e

madhe që ka bashkëpunimi midis NATO-s dhe Bashkimit European duke evidentuar se: "Bashkimi European miratoi Busullën Strategjike, dokumentin udhëzues të politikës së sigurisë dhe mbrojtjes së Bashkimit European.

Në këtë kontekst, unë besoj se, si Autoritetet Ushtarake të NATO-s, ne duhet të ndjekim përfitimin e ndërsjellë përmes bashkëpunimit më të madh ndërmjet NATO-s dhe BE-së dhe shkëmbimi i ndërsjellë i praktikave më të mira". Pjesëmarrësit në takim patën mundësinë për të vizituar Qendrën e Kontrollit të Zonës Civile-Ushtarake të Romës, ku ENAV (furnizuesi kryesor kombëtar civil i shërbimeve ATS) dhe kontrollorët e trafikut ajror të Forcave Ajrore punojnë së bashku dhe përdorimi i sigurt i hapësirës ajrore.

Ekipi i Gardës Kombëtare të New Jersey-it, vizitë në Bazën Ajrore Farkë

Në Bazën Ajrore Farkë ekipi Amerikan, i kryesuar nga nënoficeri i Gardës Kombëtare të New Jersey-it, kryekapter Mark A. Leonard zhvilloi një vizitë pune në kuadër të vlerësimit dhe vijimit të asistencës e mbështetjes së zhvillimit të trupës së nënoficerëve në Forcat e Armatosura. Qëllimi i kësaj vizite ishte njohja nga afër me arsimimin dhe trajnimin e trupës së nënoficerëve, kurrikulat dhe programet mësimore që zhvillohen në strukturat stërvitore të Forcës Ajrore. Ekipi i nënoficerëve amerikanë i shoqëruar nga ekipi i nënoficerëve të Forcave të Armatosura kryesuar nga kryekapteri i shefit të Shtabit të Përgjithshëm Albert Koka, u mirëpritën fillimisht nga nënoficeri i Forcës Ajrore kapter Aida Guxha së bashku me nënoficerë të Bazës Ajrore Farkë, ku shkëmbyen mendime mbi bashkëpunimin për zhvillimin e nënoficerëve në të ar-



dhmen. Ekipi u prit nga komandanti i Bazës Ajrore Farkë nënkolonel Julian Dulemata, i cili i njohu me misionin dhe detyrat e Bazës, përgatitjen e kandidatëve për pilotë helikopteri si dhe diskutuan mbi perspektivën e trajnimit të tyre të mëtejshëm në Shtetet e Bash-

kuara të Amerikës, në kuadër të programit të trajnimit për pilotë helikopteri "Blackhawk", me të cilët do të pajisen Forcat Ajrore Shqiptare në të ardhmen. Ekipi Amerikan shprehu vlerësimet për vijimin e bashkëpunimit ushtarak në të ardhmen.

KAMPIONATI

Në Garnizonin Rinas u zhvillua ceremonia e mbylljes së kampionatit të ping – pongut në rang të Forcave të Armatosura, ku Forca Ajrore mori pjesë me përfaqësues nga Shtabi i FAJ së bashku me ekipet e meshkujve dhe të femrave.

Gjatë ditëve të kampionatit, lojtarët e Forcës Ajrore zhvilluan ndeshje ping-pongu në ekip dhe individuale duke u vlerësuar me certifikata dhe medalje në ndeshjet individuale.

Forca Ajrore u përfaqësua me dy ekipe, ekipi i meshkujve i përbërë nga nënkolonel Skerdilajd Zavalani, major Artan Vathi dhe major Albert Dervishi, i cili zuri vendin e dytë për meshkuj.

Ekipi i femrave përbëhej nga kapiten Esmeralda Kola dhe kapiten Doloresa Bushi, e cila zuri vendin e tretë për femra.

Forca Ajrore vlerësohet me medalje në dy ekipet, meshkuj dhe femra në kampionatin e ping-pongut në rang FA



Batalioni I i Këmbësorisë (b1k) Bishte stacioni i radhës ku Forca Tokësore (FT), në bashkëpunim me Qendrën e Personel-Rekrutimit (QPR) dhe Qendrën e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeu i FA (QK-MBMMFA) organizoi dhe zhvilloi “Ditën e Hapur” me gjimnazet e zonës së Shkodrës. Nënkolonel Ali Mali, komandant i b1k, pasi u uroi mirëseardhjen të rinjve gjimnazistë i njohu ata shkurtimeisht me misionin dhe detyrat që realizon ky repart i rëndësishëm i Forcës Tokësore për zonën e veriut.

Më tej gjimnazistët ndoqën nga afër një sërë demonstrimesh të përgatitura nga efektivët e batalionit III të Këmbësorisë. Të rinjtë, ndoqën nga afër organizimin dhe zhvillimin e një ore përgatitje fizike, kjo kryesisht me rekrutët e rinj që po zhvillojnë kursin e Stërvitjes Individuale Bazë (SIB). Më tej, stacionet e ngritura stërvitore ishin ata të goditjes së objektit dhe çlirimit të pengjeve, veprimet alpinistike, luftimit trup me trup etj. Pjesëmarrësit shuan kureshtjen e



“Ditë e Hapur” në Batalionin I të Këmbësorisë me gjimnazet e zonës së Shkodrës

tyre duke u bërë edhe vetë pjesë e veprimeve në stacionet stërvitore, duke prekur nga afër mjetet dhe pajisjet në përdorim nga trupat e b1k. Nëpërmjet materialeve dhe broshurave të përgatitura nga QPR, gjimnazistët morën të gjithë

informacionin e duhur, se si mund të bëhen pjesë e Forcave të Armatosura. Aktiviteti vijoi me vizitë në stendat e ekspozimit të pajisjeve, mjeteve dhe armatimit të b1k dhe u mbyll me një program artistik nga QKMBMMFA.

STËRVITJET

Në Forcën Tokësore vijon trajnimi i rekrutëve të Stërvitjes Individuale Bazë (SIB).

Stërvitja Individuale Bazë është kursi që certifikon ushtarët e rinj, të cilët do të shërbejnë në Forcat e Armatosura.

Forca Tokësore mban në gatishmëri kapacitetet e nevojshme operacionale për ruajtjen dhe mbrojtjen e pavarësisë, sovranitetit dhe tërësisë territoriale të Republikës së Shqipërisë.

Forca Tokësore si njësi prioritare në strukturën e Forcave të Armatosura, ka angazhime në operacione të emergjencave civile në ndihmë të komunitetit në rast fatkeqësish natyrore, si përmytje, zhblokim rrugësh dhe shpërndarje ndihmash në rast reshesh dëbore, operacione shuarje zjarresh, bashkëpunon me institucione të tjera kombëtare në ndalimin e



Forcat Tokësore vijojnë trajnimin e rekrutëve të Stërvitjes Individuale Bazë (SIB)

trafikimit ilegal, të kontrabandës, personave, armëve konvencionale, në Shqipëri. Trajnon, stërvit dhe

merr pjesë me trupa në misionet e mbështetjes së paqes në kuadër të NATO-s, BE-së dhe OKB-së.

Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra zhvilloi një vizitë zyrtare në Forcën Detare të Belgjikës

Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, zhvilloi vizitë zyrtare në Belgjikë, me ftesë të komandantit të Forcës Detare të Belgjikës kundëradmiral Jan De Beurme. Delegacioni shqiptar u prit nga komandanti i Forcës Detare të Belgjikës dhe mori pjesë në paradën detare të organizuar me rastin e festimit të 75-vjetorit të Themelimit të Forcës Detare të Belgjikës. Në këtë event mori pjesë edhe shkëlqesia e tij, mbreti i Belgjikës Philippe Léopold Louis Marie si dhe të ftuar të tjerë vendas dhe të huaj. Kundëradmiral Agastra zhvilloi një vizitë dhe në Qendrën e Trajnimit të Luftës Detare me Mina gjatë së cilës u shoqërua nga komandanti i Forcës Detare të Belgjikës. Gjatë vizitës në këtë qendër, delegacioni u njoh me kapacitetet stërvitore, trajnuese dhe teknologjinë moderne në përdorim nga Forca Detare e



Belgjikës. Gjatë zhvillimit të këtyre aktiviteteve, midis komandantëve të forcave detare u diskutua mbi fushat e bashkëpunimit të përbashkët midis dy tyre për të ardhmen. Fokusi i bashkëpunimit dypalësh do të jetë zhvillimi i kapaciteteve të Forcës Detare shqiptare në lidhje

me krijimin e Grupit për Operacionet Detare të Luftës me Mina në Ujëra Shumë të Cekëta.

Më tej, kundëradmiral Adnand Agastra ftoi homologun e tij të zhvillojë një vizitë zyrtare në Shqipëri me qëllim vijimin e bashkëpunimit të mëtejshëm bilateral.

FORCA DETARE

Në bashkëpunim me Bashkinë e Sarandës dhe Forcën Detare, në qytetin e Sarandës u zhvillua aktiviteti "Ditët e Detarisë", me pjesëmarrjen e kryetarit të Bashkisë Sarandë Ardian Gurma, zëvendëskomandantit të Forcës Detare kapiten i Rangut I Ferdinand Kreshpani, me përfaqësues dhe veteranë të Flotës Luftëtare, Flotës Tregtare, përfaqësues të Forcës Detare, gjithashtu edhe pjesëmarrës gjimnazistë të qytetit të Sarandës për të ndjekur këtë aktivitet.

Aktiviteti u zhvillua në Galerinë "Art Saranda", në të cilën u paraqit një ekspozitë me fotografi, dokumente, piktura dhe botime historike. U nderuan me "Certifikatë Mirënjohje"

Zhvillohet ditë e hapur me rastin e "Ditëve të Detarisë", Sarandë



(pas vdekjes), simboli i detarisë sarandjote, Gaqe Lepuri dhe disa veteranë të detarisë. Pjesëmarrësit vizituan edhe anijen e Forcës

Detare "Butrinti" të ankoruar në portin e qytetit, e cila ishte e hapur për vizitorët gjatë gjithë ditës deri në mbrëmje.

SAMITI "CHENS 2022"

Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra mori pjesë në Samitin e Komandantëve të Forcave Detare të Europës

Komandanti i Forcës Detare kundëradmiral Adnand Agastra mori pjesë në Samitin e Komandanteve të Forcave Detare të Europës (CHENS 2022) në Bukuresht, Rumani. Në këtë samit morën pjesë komandantët e forcave detare nga 24 shtete europiane, anëtarë të NATO-s dhe të Bashkimit Europian, si dhe komandanti i Forcave Detare të Aleancës (MARCOM) dhe komandanti i Forcave Detare Amerikane për Europën dhe Afrikën.

Në samit u diskutua mbi objektivat kryesore si: zhvillimin e bashkëpunimit në fushën detare, analizimin e çështjeve detare europiane si dhe promovimin e pikëpamjeve detare në forumet vendimmarrëse. Tema kryesore e "CHENS 2022" ishte optimizimi i komandim - kontrollit ndërmjet njësive detare në det.

Ky samit për vitin 2022 u organizua nga Forca Detare e Rumanisë.

Kundëradmiral Adnand Agastra gjatë ditëve të qëndrimit në Rumani pati takime



dhe me ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Rumani Ilir Tepelena, atasheun ushtarak në Rumani kolo-

nel Leonard Çoku dhe ushtarakët shqiptarë me detyra në shtabet e NATO-s në Rumani.

HARTAT DETARE

Shqipëria anëtar i 98-të i Organizatës Ndërkombëtare të Hidrografisë, IHO

Falë rritjes së aftësive dhe kapaciteteve të Forcës Detare dhe mbështetjes së vyer të Norvegjisë, Shqipëria bëhet anëtar i 98-të i Organizatës Ndërkombëtare të Hidrografisë, IHO.

Pas një pune disavjeçare, kapitenët e anijeve kanë një pamje më të qartë të bregdetit shqiptar, çka rrit trafikin detar në ujërat tona. Tashmë hartat detare të prodhuara nga Shërbimi Hidrografik i Forcës Detare do të njihen zyrtarisht për cilësinë dhe standardet e tyre, njëloj si ato të vendeve të tjera anëtare të IHO.



Forcat e Armatosura në ndihmë të komunitetit, në fshatin Zall-Torrë të njësisë Proptisht në bashkinë e Pogradecit

Specialistët e Kompanisë së Urave të Batalionit të Xhenios të Komandës Mbështetëse, kanë realizuar me sukses ndërtimin e urës tip "Bailey" me gjatësi 54 m, seksion 2/1 dhe me peshëmbajtje deri në 40 ton. Kjo urë u ndërtua mbi lumin Shkumbin në fshatin Zalltore, Njësia Administrative, Proptisht, Bashkia Pogradec.

Në inspektimin e punimeve ishte i pranishëm ministri i mbrojtjes Niko Peleshi, i cili përgëzoi Kompaninë e Urave për punën e tyre të palodhur: "Jam i kënaqur që sot inaugurojmë këtë urë, që bën të mundur, pothuajse për 4000 banorë, t'iu shkurtohet rruga me thuajse 25 km për në shërbimet e tyre apo rrugës nacionale, sepse kjo rrugë përveç banorëve të zonës bën të mundur aksesin në potenciale të fshehura turistike siç është ura e Golikut. Kompania e Urave do të ketë gjithmonë vëmendjen dhe mbështetjen e duhur në kontributin e tyre të vyer ndaj komunitetit në nevojë", -do të shprehej ministri Peleshi. Të pranishëm në inaugurimin e urës ishin dhe shefi Shtabit të Komandës Mbështetëse kolonel Arben Dhuli, komandanti i Batalionit



të Xhenios, kolonel Hajdar Gurra, kryetari Bashkisë Pogradec, Ilir Xhangolli si dhe administratori i zonës së Proptisht, Ramiz Pura. Më pas fjalën e mori komandanti i Batalionit të Xhenios kolonel Hajdar Gurra i cili u shpreh se lidhja e këtyre zonave rurale nëpërmjet urave "Bailey" janë një tregues i qartë i mbështetjes së Forcave të Armatosura për popullsinë në çdo situatë nevojë, mbështetje e cila do të vijojë në çdo rast që të jetë e nevojshme.

Ndërtimi i kësaj ure është i një rëndësie të veçantë nga pikëpamja

sociale dhe ekonomike në shërbim të një komuniteti prej rreth 4000 banorësh, sepse kjo urë bën të mundur lidhjen e fshatrave: Zalltore, Selishtë, Baribardhë, Slatinjë, Manastrec, Dritas, Stranik, Farret dhe Stravaj. Gjithashtu bën të mundur lidhjen e katër shkollave 9-vjeçare, 2 shkollave të mesme si dhe 8 qendra, gjithashtu bënë lidhjen me rrugën nacionale Librazhd - Pogradec si dhe rrugën e re Qukës - Gaf Plloç, duke iu mundësuar lehtësi në përfitimin e shërbimit shëndetësor sa më të shpejtë e në lëvizje të popullsisë së kësaj zone.

Pas përfundimit të operacionit, municioni i paplasur u transportua për në Batalionin e Xhenios, ku do të magazinohet deri në asgjësimin përfundimtar të tij.

Specialistët xhenierë të EOD të Batalionit të Xhenios ditën e sotme pas sinjalizimit për gjetjen e një predhe të paplasur artilerie thërrmuese të kalibrit 75 mm në zonën Mengel, Elbasan, kanë shkuar menjëherë në vendngjarje dhe pas kryerjes së vlerësimit të rastit, ndoqën procedurat për mënjanimin e rrezikut të municionit të evidentuar në këtë zonë. Pas vlerësimit, u konstatua nga ana e ekipit si

Specialistët e Batalionit të Xhenios eliminojnë rrezikun e municionit të gjetur në Mengel, Elbasan



municion i prekshëm e i lëvizshëm, që nuk kërkon asgjësim në vend. Komanda Mbështetëse ka dhënë kontribut të konsiderueshëm në vite duke shpalosur një kapacitet të vyer jo vetëm në shërbim të misionit të Forcave të Armatosura për pastrimin e asgjësimit e municioneve të paplasura, por edhe në shërbim të komunitetit për eliminimin e rreziqeve të municioneve të gjetura.



Fillon Kursi i 73-të Fillestar i Nënoficerit në QAPN

Në Qendrën e Arsimit Profesional të Nënoficerit u hap kursi i 73-të Fillestar i Nënoficerit i përbërë nga 56 kursantë.

Synimi i këtij kursi është hedhja e bazave për karrierën e Nënoficerit, marrjen e njohurive teorike-praktike për drejtimin e grupit dhe niveleve të njësura me të, si dhe shkëputjen nga përgjegjësia individuale në aftësinë dhe përgjegjësinë si drejtues grupi. Pjesëmarrësit nga strukturat e Forcave të Armatosura që do të ndjekin kursin do të marrin njohuritë themelore prej një periudhe 5-javore.



Në kuadër të aktivitetit "ALB SPP2200108ICE Senior NCO Development", Komandanti i Qendrës së Arsimit Profesional të Ushtarëve Bunavi, Nënkolonel Bujar Fejzo, priti ekipin e Nënoficerëve të lartë të GKNJ, të kryesuar nga Nënoficeri i Gardës Kombëtare të New Jersey-it, kryekapter Mark A. Leonard.

Ekipi i GKNJ i shoqëruar nga Nënoficeri i QAPU, Kapter Sefedin Muka u njohën nga afër me Kurset Institucionale dhe Programet Stërvitore që zhvillohen në këtë Qendër, si dhe u diskutua për mënyrën e zhvillimit të procesit stërvitor.

Më pas, ekipi i GKNJ ndoqi programin stërvitor që po zhvillohet me efektivat rekrut kandidat për ushtar/detar aktiv të Kursit të Stërvitjes Individuale Bazë.

QAPU pret ekipin e Gardës Kombëtare të New Jersey-it





**INTERVISTË ME
KOMANDANTIN E
QENDRËS SË
PERSONEL-
REKRUTIMIT**



Intervistoi:
Shefe e Sektorit të Botimeve
Anjeza Musollari

Kolonel Altin Gjetaj: QPR, qendra avangard e Forcave të Armatosura

Komandant Gjetaj, fillimisht ju uroj suksese në drejtimin e Qendrës së Personel-Rekrutimit, kësaj strukture të rëndësishme të Forcave të Armatosura të RSH.

Me interes për lexuesin do të ishte dhe një prezantim i shkurtër i formimit tuaj ushtarak.

Si nisi rrugëtimi juaj nën uniformën ushtarake?

Rrugëtimi në uniformë ushtarake ka filluesen e hershme në vitin 1983, kur fillova shkollën e mesme ushtarake "Skënderbej". Janë plot 39 vite që mbaj këtë uniformë në detyra e funksione të ndryshme, në disa rrethe të vendit, si Kukës, Pukë, Shkodër, Krujë, Durrës e tani në Tiranë.

Çfarë do të thotë për ju, të jesh pjesë e Forcave të

Armatosura?

Të jesh pjesë e Forcave të Armatosura është nder dhe krenari sepse nuk përfaqëson vetëm veten, por përfaqëson njëkohësisht një nga strukturat e rëndësishme të shtetit, ushtrinë/Forcën e Armatosur. Është privilegj qenia ushtarak i Forcave të Armatosura, por është njëkohësisht edhe përgjegjësi shumë e madhe.

Para pak kohësh ju jeni emëruar Komandant i Qendrës së Personel-Rekrutimit, por, prej vitesh jeni pjesë e kësaj strukture.

Kur e ka filluar aktivitetin Qendra e Personel-Rekrutimit?

Qendra e Personel-Rekrutimit është krijuar me urdhër



të MM, nr. 98 datë 22.06.2007, që shënon edhe fillimin e aktivitetit të saj. Fillimisht nga krijimi i saj në 2007 deri në muajin mars 2010 kjo strukturë ka qenë në vartësi të Komandës Mbështetëse. Në strukturën e saj, kishte personel prej 32 vetash, si dhe 12 Qendra Rekrutim-Mobilizimi në qarqe. Nga muaji mars 2010, Qendra e Personel-Rekrutimit është në vartësi të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së. Struktura e QPR-së ka ndryshuar edhe në vitet 2010, 2012, 2014 si dhe në vitin 2017. Me ndryshimet që iu bënë strukturës së Qendrës së Personel-Rekrutimit në vitin 2017 (me urdhër të MM, nr. 43 datë 19.01.2017, i ndryshuar), në strukturën e saj u shtua Qendra e Rekrutim-Mobilizimit, në përbërje/vartësi të saj u shtuan sektorët: Sektori i Pritjes dhe Testimit & Sektori i Marketingut; Sektori Rekrutimit për Officer, Ushtar, Rezervë për Forcat/Komandat; Sektori i Rekrutimit për Officer, Ushtar, Rezervë në Qark/Rreth në 12 qarqet.

Cili është misioni i Qendrës së Personel-Rekrutimit?

Misioni i Qendrës së Personel-Rekrutimit është: Rekrutimi i kandidatëve për oficer dhe ushtar/detar aktiv, përpunimi, administrimi i dokumentacionit dhe të dhënave individuale të personelit ushtarak aktiv, në rezervë/lirim dhe atij civil, përpunimi i dokumentacionit për përkujdesje e përfitime suplementare të ushtarakëve në rezervë/lirim, evidentimin e burimeve njerëzore dhe materialeve që do të mobilizohen gjatë periudhës për të cilën kërkohet vendosja e masave të jashtëzakonshme.

Mbi bazën e këtij misioni janë të përcaktuara edhe detyrat kryesore të saj, ku ndër to është "Rekrutimi i kandidatëve për oficerë e ushtar/detar aktiv, sipas planeve të miratuara nga Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm".

Cfarë shërbimesh ofron Qendra e Personel-Rekrutimit?

Qendra e Personel-Rekrutimit (QPR) është struktura e vetme e Forcave të Armatosura që administron dhe

përpunon dokumentacionin për përfitimin e të drejtave në fushën e pensioneve dhe të përfitimeve suplementare sipas ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; ligjit nr. 8097, datë 21.03.1996, "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", i ndryshuar; si dhe VKM nr.793, datë 24.9.2010, "Për zbatimin e ligjit nr.10142, datë 15.5.2009", i ndryshuar, ligjet e tjera të fushës së përfitimeve sociale, pensioneve e SHDUA.

QPR është struktura që mban korrespo-ndencë, bashkëpunon dhe përpunon dokumentacion për përfitime suplementare me strukturat e tjera shtetërore, sidomos me Institutin e Sigurimeve

Shoqërore dhe me 12 Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore në qarqe, agjencitë rajonale në të gjithë vendin. Ky bashkëpunim është dhe në fushën e përpunimit të dokumentacionit për shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv.

Vlen të theksojmë se, nga data 01 maj 2022, Qendra e Personel-Rekrutimit çdo shërbim e kryen online, sipas VKM nr. 252, datë 29.4.2022 "Për procedurat e ofrimit të shërbimeve online nga institucionet shërbim-ofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre".

Si është rritur ndër vite struktura dhe objektivi i saj?

Nga krijimi në vitin 2007 deri sot, në përputhje me misionin dhe detyrat e përcaktuara Qendra e Personel-Rekrutimit është ristrukturuar disa herë duke iu shtuar përgjegjësitë, detyrat, por është rritur edhe në personel.

- Në vitin 2012 u bë përqendrimi i të gjithë dokumentacionit të ish-qendrave të rekrutim-mobilizimit në qarqe, i dosjeve të ushtarakëve në rezervë të cilat administroheshin nga strukturat e FA-së, si dhe filloi përpunimin e të gjithë dokumentacionit për pensione dhe përfitime suplementare të ushtarakëve në rezervë/lirim.

- Në periudhën 2010-2012 në bashkëpunim me kompaninë CUBIC, u bë e mundur ngritja dhe funksionimi i sistemit të automatizuar i të dhënave të personelit aktiv të FA-së.

- Në vitin 2013 komisionet e karrierës e zhvilluan aktivitetin e tyre mbi bazën e të dhënave që përmbante sistemi i automatizuar, i cili në vijimësi është përmirësuar me elementë të tjerë shtesë.

- Në vitin 2014 QPR bëri një marrëveshje me Postën Shqiptare, nëpërmjet të cilës ofrohen të gjitha shërbimet për qytetarët. Kjo bëri që të shmangej paraqitja e

qytetarëve në institucion dhe shërbimi të ofrohej nëpërmjet postës. Ndërsa që nga janar 2020 e në vijim marrja e këtyre shërbimeve bëhet nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania.

Cili është parimi i mobilizimit në FA?

Në kuptimin ligjor "Mobilizimi ushtarak" është detyrimi ligjor i shtetasit, person fizik e juridik, për të marrë pjesë ose për të siguruar plotësimin e njërive e reparteve të strukturave ushtarake me personel, materiale, teknike, kafshë, automjete e mjete të tjera të nevojshme, kur situata e kërkojnë. Më tej ligji përcakton: "Mobilizimi ushtarak në Republikën e Shqipërisë kryhet në kohë paqe ose në kohë lufte. Mobilizimi është i përgjithshëm ose i pjesshëm. Kriteret e vendosjes së gjendjes së mobilizimit dhe të çmobilizimit, të përgjithshëm ose të pjesshëm, përcaktohen me ligj. Mobilizimi ushtarak në kohë paqe planifikohet, organizohet e drejtohet në përputhje me synimet dhe përcaktimet në dokumentin e politikës së mbrojtjes, të strategjisë së sigurimit dhe strategjisë ushtarake të Republikës së Shqipërisë, nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, komandat e forcave dhe ato të mbështetjes".

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 103, datë 10.2.2016 "Për miratimin e planit të mobilizimit të përgjithshëm ose të pjesshëm të burimeve njerëzore e materiale të vendit gjatë periudhës për të cilën kërkohet vendosja e masave të jashtëzakonshme", ka përcaktuar detyrime për komponentin rezervë, gjë që ka përcaktuar detyrime për institucione e struktura, përfshi edhe QPR-në.

Njëkohësisht, Rishikimi i Strategjisë së Mbrojtjes (VKM nr. 628 datë 25.09.2019) ka përcaktuar se "Niveli i ambicies së FARSH-ve është i ndërthurur me kapacitetet e NATO-s, të cilat plotësojnë atë pjesë të kapaciteteve operacionale që vendi ynë nuk ka burime të mjaftueshme dhe mundësi për t'i zhvilluar". Në fund të pikës 4.4. të kreut IV "Sistemi i mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë" të VKM nr. 628 datë 25.09.2019, përcaktohet se: "Numri i personelit të FARSH-ve do të jetë në vitin 2020: 8500 forca aktive dhe 2100 forca rezerviste (25% të forcave aktive)".

Shtyllat kryesore të punës së kësaj qendre, janë: Rekrutimi për ushtar/detar aktiv në Forcat e Armatosura, rekrutimi për oficer, studime ushtarake brenda e jashtë vendit, është porta hyrëse e FA-së; administrimi, menaxhimi e përditësimi i të dhënave në dosjet personale dhe në sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore për të gjithë personelin ushtarak e civil në Forcat e Armatosura; përkujdesja ndaj ushtarakëve në rezervë, lirim, pension si dhe familjeve të tyre, ofrimin e shërbimeve të ndryshme në fushën e mbrojtjes dhe evidentimi i burimeve njerëzore e materiale për komponentin e rezervës.

Cilat kanë qenë sfidat më të mëdha të këtij institucioni?

Sfida e institucionit që drejtoj, për vitin 2022 është: reformimi i procesit të rekrutimit në FA, i cili synon rridhësimin e seksioneve të rekrutimit në qarqe, përmirësimin e strukturës së rekrutimit duke e kompletuar me personel ushtarak; vënien në funksion të një qendre të lëvizshme për pritjen/testimin e kandidatëve për ushtarë/detar aktiv që do të bëjë lehtësimin e procedurave të rekrutimit; ndryshim të akteve ligjore e nënligjore që kanë të bëjnë me rekrutimin në FA; si dhe përmirësimin e procedurave të marketingut.

Cila është qasja juaj për arritjen e objektivave të QPR-së?

Për arritjen e objektivave të QPR-së puna ka filluar, janë hartuar programe dhe procedurat e nevojshme për implementimin e ndryshimeve. Aktualisht jemi në përfundim të hartimit të akteve nënligjore për lehtësimin e procedurave të rekrutimit të kandidatëve për ushtarë/detar aktiv për periudhën nga data 12.09.2022-18.11.2022. Lehtësirat kanë të bëjnë me kriteret e rekrutimit, dokumentacionin e nevojshëm, si dhe procedurat e aplikimit dhe të testimit.

Si rekrutohen ushtarët aktiv?

Shtetasit që dëshirojnë të shërbejnë në FA si ushtar/detar aktiv, do të aplikojnë online, në Qendrën e Personel-Rekrutimit ose në Seksionet e Rekrutimit në qarqe.

Shtetasit shqiptarë për t'u rekrutuar ushtarë/detar aktiv në FA duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- të jetë shtetas shqiptar;
- të mos jetë në ndjekje penale dhe në proces gjyqimor;
- të mos jetë dënuar nga gjykata për vepra penale;
- të ketë figurë të pastër morale;
- të mos jetë i deportuar për kryerje të veprave penale;
- të mos ketë probleme me drogën dhe alkoolin;
- të mos jetë kontingjent krimi dhe të mos jetë i evidentuar

si i tillë nga organet ligj zbatuese;

- moshë për t'u rekrutuar është 18-27 vjeç, ndërsa për specialitetin mjekësor 18-32 vjeç;

- të ketë kryer arsimin minimalisht 9-vjeçar, brenda ose jashtë vendit;

- të kenë gjatësinë trupore mbi 165 për meshkujt dhe mbi 160 cm për femrat;

- të ketë kryer kontrollin shëndetësor dhe të jetë vlerësuar i aftë për ushtarë/detar aktiv nga Komisioni Mjekësor Ushtarak;

- të ketë rezultuar pa probleme gjatë verifikimit të kushtit të sigurisë të kryer nga strukturat përgjegjëse.

Kandidatët për ushtarë/detar aktiv në FA paraqesin këto dokumente për regjistrim:

- Kërkesë me shkrim;
- Fotokopje të kartës së identitetit;
- Formulari i vetëdeklarimit;
- Dy fotografi të përmasave 4x6 cm dhe dy fotografi të përmasave 9x12 cm;
- Fotokopje e noterizuar dëftesës/diplomës shkollës/universitetit;

- Fotokopje e dëshmisë, certifikatës për aftësitë profesionale, gjuhësore, etj. (nëse ka);

- Dokumenti i qendrës shëndetësore i lëshuar nga mjeku i familjes;

- Ekzaminimet mjekësore për agjent infektiv (Hepatit B, C, sifiliz, etj.), grupin e gjakut të lëshuar nga drejtoritë e shëndetit publik ose laborator mjekësor të licencuar për këto analiza;

- Vërtetim nga prokuroria, gjykata dhe dëshmi penaliteti.

A kanë interes të rinjtë shqiptarë për t'u bërë pjesë e Forcave të Armatosura?

Referuar mbështetjes nga Ministri i Mbrojtjes dhe shefi Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, për përmirësimin e pozitës të statusit së ushtarakut, vëmendja e qeverisë gjatë vitit 2022 është rritja e pagës në masën deri 30 % të saj.

Kjo ka sjelle dhe një qasje të re dhe interesim më të madh tek të rinjtë shqiptarë për t'u bërë pjesë e Forcave të Armatosura.

Cilat janë benefitet e të qenit pjesë e Forcave të Armatosura?

Punë e garantuar, pushim vjetor, angazhim në misione paqeruajtëse, arsimim brenda dhe jashtë vendit falas, sigurim shoqëror dhe shëndetësor, qira banese, trajtim me ushqim, etj.

Koncepti i përdorimit të tankut, drejt ndryshimit apo drejt dështimit

Në Ukrainë po vërtetohet rënia e mitit të fuqisë së mjeteve të blinduara, si të aftësive të tyre sulmuese me zjarr, ashtu edhe mbrojtjes së ushtarëve brenda kupolave të çelikut. Bombardime me avion nga ajri dhe goditjet me tanke janë të ngjashme me luftën e II-të botërore në humbje të mëdha në njerëz.



KOLONEL HYSNI GJERGJI
IKSHU

Ekspertët ushtarakë, pas 3 muajve "luftimi mësymës me tanke" të ushtrisë ruse, shtrojnë pyetjen nëse ka mbaruar epoka e tankeve të paktën në këtë lloj luftimi? Bazuar në evidencat e humbjeve, a është kjo luftë nekrologji për tankun si një instrument zjarri? A mbetet tanku kalorësia e shekullit të 21-të? Apo është një sistem mbështetës, si luftanija në Luftën e Dytë Botërore? Apo është akoma, arma e zgjedhur për luftime tokësore mbrojtëse dhe mësymëse? A vazhdon tanku të ketë rol në zjarrin e fuqishëm në lëvizje, por me një koncept dhe

doktrinë të rishikuar përdorimi? Nëse përgjigja është po apo ndoshta, atëherë hapi tjetër për industrinë e luftës do të jetë se si të mbrojmë tankun dhe si ta përsosim tankun dhe mjetet e tjera të blinduara, që t'i përshtaten fushës së luftimit dhe përballojnë armët kundërtank në lulëzim. Nisur nga ngjarjet në Ukrainë, kjo pyetje duhet trajtuar objektivisht dhe urgjentisht.

Në Ukrainë po vërtetohet rënia e mitit të fuqisë së mjeteve të blinduara, si të aftësive të tyre sulmuese me zjarr, ashtu edhe mbrojtjes së ushtarëve brenda kupolave të çelikut. Bombardime me avion nga ajri dhe goditjet me tanke janë të ngjashme me luftën e II-të botërore në humbje të mëdha në njerëz. Humbje të mëdha janë shënuar edhe në personelin ekuipazh të tankeve, megjithëse kanë qenë nën mbrojtjen e "brumbujve metalikë të tokës", si i quan Kadare.

Tanke ruse të shkatërruar në rrugët e Ukrainës, për të cilët ushtria ukrainase thotë se janë mbi 2000, ndërsa ajo ruse rreth 300, shikohen në çdo cep të Ukrainës nga ku autokolona ruse ka kaluar. Cilido të jetë numri i saktë i tankeve të shkatërruar dhe ushtarëve të vrarë brenda tyre, përsëri mbetet shumë i madh për 90 ditë luftë. Ushtria Ruse para 24 shkurtit, vlerësohej si ushtria e dytë më e mirë në botën moderne, ndërsa ushtria ukrainase ishte e nënvlerësuar, por që ka shfaqur aftësinë e saj luftarake fituese të bazuar vetëm në "shpirtin luftarak fitues dhe një grumbull armësh të dhuruara" nga vendet perëndimore, ndër kryesoret raketa supi të drejtuara kundërtank.

Gjeneralmajore Kathryn Toohey, nga Australia, në vitin 2019 i përcakton kështu tanket: "Tanket janë si xhaketat e darkës. Nuk ju duhen shumë shpesh,



por kur nevojiten, asgjë tjetër nuk mund t'i zëvendësojë". Gjeneralja shpjegon se tanku ka rezistuar dhe nuk është koha për funeralin e tij, përveç nëse provohet dështimi i tij në disa beteja. Është shumë herët për përfundime të tilla, por duhet të përpiqemi të kuptojmë pse mjetet e blinduara ruse janë paraqitur kaq të pambrojtura kryesisht, ndaj granatave kundërtank të supit.

"Tanku vdiq, jetë të gjatë Javelin", -shkruan "The Telegraph", më 23 prill, bazuar në statistikat e raportuara nga fronti i luftës në Ukrainë. Fakt është se tanket që deri dje përveç fuqisë së zjarrit, përcillnin supremaci edhe frikësim tek pala kundërshtarë. Sot në Ukrainë po kthehen në panik, pasi ekuipazhet ndjehen të tmerruar brenda "ferrit" të kupolave të çelikut. Dizenjimi i tankut është një problem, pasi vendosja e municioneve për qark ekuipazhit dhe nën ndenjës të tyre, e bën shumë të rrezikuar jetën e tyre. Nëse tanku goditet, shpërthimi i predhave të tij në procesin zinxhir, e shumëfishon efektin shpërthyes.

Doktrina dhe koncepti i përdorimit të tankut i shoqëruar me këmbësori, kërkon që ai të jetë i mbrojtur nga zjarri i afërt, të cilët supozohet të shkatërrojnë minat dhe pritrat e ngritura nga forcat ukrainase. Nëse ushtria ruse do të ishte e aftë taktikisht, atëherë ATGM (raketat të drejtuara kundërtank) do të asgjësoheshin nga këmbësoria shoqëruese, mortajat ose mbështetja ajrore dhe kështu ekuipazhet ukrainase do të sprapseshin nga këmbësoria shoqëruese ruse, të paktën do të nxirrnin jashtë rrezes së zjarrit ATGM deri në 2 km. Deri tani, këto taktika të luftimit mësymës me tanke mungojnë dhe ushtarët rusë po paguajnë çmim të lartë, për mungesën e doktrinës dhe konceptit të ri të përdorimit të tankeve në luftim mësymës.

Raketat e supit janë shumë të lira financiarisht dhe të përdorshme nga kushdo. ATGM-të janë kthyer në ferrin e mjeteve të blinduara ruse, duke ndryshuar ose vënë

në pikëpyetje përdorimin e tyre. Kërcënimi kundërtank në Ukrainë është i ndryshëm nga ai i hasur në konfliktet e mëparshme, në aftësinë që raketat e supit mund të depërtojnë në armaturën e sipërme të tankeve. ATGM-të "Javelin", të cilat i përkasin një gjenerate të re, po rezultojnë shumë të suksesshme në luftën kundër tankeve. Aq e vërtetë është kjo sa shtypi vendas dhe ndërkombëtar shkruan se të porsalindurve në Ukrainë, gjatë kësaj kohe iu venë emrat e fëmijëve "Javelin" dhe "Javelinka", si dhe duke e quajtur "shën Javelin", në nderim të legjendës së krijuar për suksesin në luftën kundër tankeve rusë. Ajo që duket e qartë në këto konflikte të këtij 10-vjeçari të fundit, është se një komb më pak i pasur mund të bëjë luftë të kombinuar me armë më të lira dhe jo shumë të sofistikuara.

Nuk është më e nevojshme për një aftësi ushtarake jashtëzakonisht të trajnuar, të shtrenjtë, për të kryer një sulm lokal ajër-tokë ose ajër-ajër. Kjo vlen edhe për Shqipërinë, e cila me terrenin që ka, territorin e kufizuar dhe kufizimet financiare, ka nevojë për një mbrojtje ajrore dhe kundërtanke të mbështetur në dronë dhe raketa supi të drejtuara kundër ajrore dhe kundërtanke. Pajisja e ushtrisë sonë me të tilla raketa siç deklaroi javën e kaluar ministri Peleshi, e modernizon dhe e përditëson mbrojtjen kundërtanke dhe është një hap drejt ndërtimit të kapaciteteve "smart", pasi ul ndjeshëm shumë investime, si në buxhet ashtu edhe në personel. Ky kapacitet me raketa "Javelin" është i bazuar në teknologjinë më të re, të testuar jo vetëm në poligone, por edhe aktualisht në fushën e luftimit.

Përveç "Javelin" mes arsenalit të huazuar ukrainas, ka shumë ATGM të tjera, që janë kthyer në makth të mjeteve të blinduara ruse. Më e vjetra por e përmirësuar, është "Panzerfaust", e cila ka bërë një paraqitje mbresëlënëse kundër kolonave të blinduara ruse.

Çfarë përfaqëson kjo raketë kundërtank, e mbajtur mbi shpatullat një

ushtari të vetëm, nga erdhi dhe pse po shkakton frikë tek ushtarët brenda tankeve të Vladimir Putinit? "Panzerfaust" u shpik në Luftën e Dytë Botërore në vitin 1943. Ishte koha kur BS krijoi tanke të klasit të parë që prodhoheshin me shumicë në seri. Si kundërvënie Gjermania zhvilloi një armë të vogël, të thjeshtë dhe të lehtë për t'u përdorur kundër tankeve, e përshtatshme të kthente çdo njeri në një "vrasës" tankesh. I quajtur "Panzerfaust" (grushti i blinduar), është në thelb një tub që lëshon një granatë shpërthyes me një ngarkesë të aftë për të depërtuar blindën e tankut. Tubi i lëshimit mund të rimbushet nëse ka koka shtesë granatash, megjithëse është i lirë në kosto. Raketa u shpërnda në luftën e dytë botërore, si mes ushtarëve me përvojë ashtu dhe fëmijëve të trajnuar me nxitim të "Volkssturm" (stuhia popullore). "Panzerfaust" kërkonte guxim të jashtëzakonisht për të vepruar në rrezen e tij efektive, pasi modelet e para ishin efektive deri në 70 metra. "Panzerfaust" ishte i aftë për të shpëtuar Rajhun nga kapitullimi, më 9 maj 1945, por u bë mjaft efektiv në ushtritë e pasluftës, duke bërë përmirësime në dizajn dhe në efektshmëri dhe në rrezen e zjarrit deri në 2,5 km.

Pas përdorimit në Afganistan nga ushtria gjermane, gjenerata e re e "Panzerfaust 3" po lufton përsëri kundër tankeve ruse, por këtë radhë ushtarët që përdorin nuk janë gjermanë por ukrainas.

Fabrika e "Dynamit Nobel Allgemeine Gesellschaft", ka punuar në versionin e fundit të raketës kundërtank nga viti 1978 deri në 1995, megjithëse u pranua nga Bundeswehr në 1992. "Panzerfaust 3" kushton 9 994 dollarë, ndërsa versioni IT-600 kushton 11 108 dollarë, për shkak të shënjestrës së tij të kompjuterizuar. Që nga viti 2003, janë prodhuar rreth 261 718 "Panzerfaust 3". Në vitin 1989, Japonia u bë fuqia e parë e huaj që bleu këtë armë, e ndjekur nga Zvicra në 1991. Që atëherë, ajo ka hyrë gjithashtu në arsenalet e Austrisë, Italisë, Holandës, Pe-

rusë, Koresë së Jugut, Irakut dhe Mauritius. Ukraina e shtoi emrin e saj në listën e blerësve të kësaj arme kur forcat ruse e pushuan atë në shkurt 2022. Në këtë kohë një sërë fuqish perëndimore dashamirëse filluan të furnizonin me armë, duke përfshirë "Panzerfaust 3", për të forcuar mbrojtjen e Ukrainës. Deri më tani, ukrainasit i kanë përdorur ato në mënyrë shumë efektive kundër mjeteve të blinduara ruse duke shkatërruar tanke që kushtojnë disa miliona dollarë.

Një tjetër kërcënim për "konceptin e përdorimit të tankeve", që kanë rezultuar të suksesshme në Ukrainë janë sistemet ajrore pa pilot. Fillimisht këta u krijuan gjatë "Luftës Globale kundër Terrorit" pas vitit 2001, të njohur si robotë fluturues të drejtuar në mënyrë automatike të pavarur nga toka. Këta UAV (mjete fluturuese pa pilot) përdorin software

dhe GPS (sistemin global të pozicionimit) për kontrollin, operimin dhe drejtimin e tyre të pavarur. "Predator-ët" dhe "Reaper-at" ishin të vlefshëm në grumbullimin e inteligjencës, mbikëqyrjes dhe zbulimit të teatrit të luftimit në terma afatgjatë, si dhe aftësinë e goditjes me saktësi me rreze të gjatë kundër objektivave kritikë. Megjithatë, këta dronë (UAV) janë kompleks, të shtrenjtë dhe me infrastrukturë masive mbështetëse të nevojshme.

Duke pasur parasysh kostot e tyre të larta dhe konkurrencën me sistemet e pilotuara nga njerëzit, ato nuk janë futur në një numër të madh në armatimin e ushtrive të botës. Ajo që ka tronditur sistemin kundërajror në mbrojtjen e tankeve kryesisht, është ardhja e dronëve më të vegjël dhe më të lirë, me "tufa" të frikshme dhe formacione

me numër të madh.

Këta dronë të armatosur në fillim morën vëmendjen e publikut në luftën kundër Shtetit Islamik të vetëshpallur ISIS. Ato që më parë konsideroheshin lodra të dyqaneve u shfaqën papritur në fushën e betejës të armatosur me granata. Në dekadën e fundit, përhapja në rritje e sistemeve ajrore pa pilot në fushën e betejës ka qenë i frikshëm. Qofshin ata, goditës, zbulues, apo lodra

dhe raketat do të zëvendësojnë efektivisht edhe artilerinë bregdetare për sa i përket mbrojtjes detare, pasi deri më tani nuk ka një kundër-armë efektive ndaj tyre. Një artikull në "Foreign Policy" shpall se: "fuqia ajrore pa pilotë, ndryshon fushën e betejës të së ardhmes", është analitik dhe bindës. Në këtë artikull, Scott Shaw, drejtori i Grupit i Luftës Asimetrike së Ushtrisë Amerikane, citohet duke vënë në dukje se në



të armatosura, sistemet ajrore pa pilot, ato janë një kapacitet luftarak me të cilën duhet të përballemi në të ardhmen.

Siç është vënë re edhe në Ukrainë, shumë sisteme ekzistuese të blinduara tokësore janë të cenueshme ndaj sulmeve nga lart-poshtë me dronë. Përdorime të tjera që kanë treguar efektivitet të dronit përfshijnë inteligjencën, mbikëqyrjen dhe zbulimin; objektivat në marshim; mjetet e komunikimit etj. UAV-të janë të vështira për t'u kapur dhe nuk kërkojnë pilotë shumë të trajnuar për t'i drejtuar; i bën sistemet ajrore pa pilot efektive për shumë arsye: kosto, reduktim i rreziqeve për jetën e pilotëve në kabinë, kërkesa të ulëta të trajnimit, reduktimin e gabimeve njerëzore etj. Dronët

Nagorno-Karabakh: "Ju mund të shihni video të tankeve që goditen nga një sistem raketor i drejtuar supi dhe sistem ajror pa pilot; pozicionet e artillerisë që goditen nga një avion pa pilot; trupat që goditen nga një sistem ajror pa pilot etj.". Ky nuk është vetëm alarmi i vdekjes për tankun, por ndoshta rilindje e një koncepti të ri të përdorimit dhe mbrojtjes së tyre.

Pyetja që shtrohet tek studiuesit ushtarakë, është se si një ushtri do të kryejë operacione të suksesshme luftarake tokësore, përballë kërcënimit të ri të paraqitur nga sistemet pa pilot që vjen nga ajri dhe raketat e supit nga toka. Mbrojtja e jetës së ushtarëve, nuk është e vetmja masë kryesore e suksesit në luftë, pasi edhe humbjet në logjistikë janë thelbësore për vazhdimin dhe mbështetjes financiare të konflikteve.

Korrupsioni vret, denigron, përbalt ndërgjegjen tënde! Ndal!

Fjala korrupsion
buron nga fjala
Latine 'corruptus'.

Kuptimi i saj në
shqip mund të
jepet si 'prishje e
plotë' e diçkaje.

Corruptus në
greqi-shten e vjetër
përkthehet 'fthóra'.
Fthóra sërisht merr
shumë kuptime;
disa prej tyre janë:
zvetënim, prishje,
kalbje, degradim etj.

Anjeza Musollari,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Winston Churchill theksonte: "Korrupsioni shërben si vaj lubrikues për makinerinë e demokracisë". Shtetari i madh britanik, me alternim të mençur, dinte të distilonte retorikën për momentet e vështira dhe cinizmin për ato më pak të vështira. Korrupsioni, sidomos ai politik, zbriti poshtë në origjinën e njerëzimit dhe gjeti terren pjellor në Romën e lashtë. Dhe me Romë të lashtë nënkuptojmë si atë republikane, ashtu edhe atë perandorake.

Akoma më pak njihet korrupsioni në Romë përpara shekullit të III-të: jo sepse ai nuk ekzistonte, por thjeshtë sepse mungojnë tekste dhe dëshmi edhe indirekte lidhur me fenomenin. Kur në fakt arrijmë në prodhimin e parë letrar, rreth vitit 200 ku shfaqen referime ndaj korrupsionit dhe imoralitetit, si në aspektin privat, ashtu edhe në atë publik.

Fjala korrupsion buron nga fjala Latine 'corruptus'. Kuptimi i saj në shqip mund

të jepet si 'prishje e plotë' e diçkaje.

Corruptus në greqishten e vjetër përkthehet 'fthóra'. Fthóra sërisht merr shumë kuptime; disa prej tyre janë: zvetënim, prishje, kalbje, degradim etj. Për Aristotelin koncepti i 'fthóra-s', të "On Generation and Corruption", vendoset përballë lindjes, d.m.th. ajo do të thotë 'vdekja' e një qenieje. Por në politikë, Aristoteli me të njëjtin term kuptonte 'devijantin' ose 'shmangësin' nga një detyrë ose objektiv i paracaktuar. Aristoteli e lidh korrupsionin drejtpërdrejt me ndershmërinë dhe pushtetin. Sipas tij, "ndryshimi midis ndershmërisë dhe korrupsionit është se të jesh i korruptuar do të thotë të kesh pushtet të pakufizuar mbi një pronë ndërsa të jesh i ndershëm do të thotë qeverisja e një shteti sipas nevojave të njerëzve". Më tej, ai hulumton imanencën (brendaqenësinë) e korrupsionit me pushtetin. Sipas tij, 'korrupsioni politik nuk është cilësi e individit, një e vetë natyrale, por karakteristikë e pushtetit, e çdo lloj pushteti, dhe pasojë e ofiqeve.

Në botën moderne, dhe kryesisht në kampin e "demokracisë" parlamentare dhe kapitalizmit, që tashmë ka marrë karakter global, korrupsioni lidhet më shumë me braktisjen e interesit publik në emër të interesit privat. Përqendrimi i pushtetit dhe ndershmëria nuk përmenden! Në anën tjetër, tradita marksiste, siç tregon Robert Mayer-i në një studim me mjaft interes, nuk shqetësohet shumë për shkakun e korrupsionit. Ndryshe nga Marks, Lenini shqetësohet shumë për korrupsionin e 'masave'.

Përparimi i lëvizjes kërcënohej nga korrupsioni i udhëheqësve të saj dhe qoftë edhe anëtarët e zakonshëm, burimi i atij korrupsioni që është i shoqërisë borgjeze dhe pasurisë së saj. Marks dhe Lenini nuk mohuan kapitalizmin sepse ai ishte në mënyrë të pashpresë i korruptuar, por ata besonin se ai duhet të ushtronte një



influcencë korruptuese mbi lëvizjen e cila kërkoi të transformonte shoqërinë borgjeze. Për republikanët termi korrupsion është ndër përshkruesit më emblematikë të shekullit të 21-të, menjëherë pas zbulimeve teknologjike. Fatkeqësisht, një fenomen i tillë është krumbi i cili ha trungun nga brenda. Megjithatë korrupsioni si fenomen bën vetëm rishpërndarjen (dhe jo krijimin) e vlerave, të krijuara brenda një shoqërie, tek të pasurit dhe rrethi i tyre, fatkeqësisht mbi barrën e më të varfërve që paraqesin një shumicë. Nuk ka as edhe një shtet të vetëm në botë, i cili nuk përballlet me cilëndo nga format e korrupsionit në një dozë të caktuar, ku kjo shumë thjeshtë mbështetet nga fakti se mbi 6 miliardë njerëz në botë jetojnë në vende të cilat kanë probleme serioze me korrupsionin (Transparency International, 2015).

Kur dikush flet mbi korrupsionin, fatkeqësisht ne kemi në mendje vetëm termat si 'vjedhje', 'shpëlarje parash' ose forma të tjera të ngjashme më të përhapura të tij.

Nëse korrupsionin e limitojmë vetëm në këto trajta të shfaqjes së tij, atëherë ne nuk mund të gjejmë zgjidhje për korrupsionin sepse nuk e kemi definuar akoma mirë atë si problem. Edhe pse de jure ekzistojnë një mori ligjesh të cilat definojnë sanksionet për korrupsion apo edhe shumë shkelje tjera, thënia se "Rregullat janë bërë për tu thyer", ka zënë një vend dominant.

Arsyeja pse ekziston perceptim kaq i lartë për korrupsionin, është sepse janë shumë të dukshme frytet e hidhura të tij, korrupsioni është shumë më shumë se sa ajo çfarë ne kuptojmë me termin 'korrupsion tradicional'. Ai në një farë mënyre degëzohet duke i prekur së pari të gjitha institucionet, komunitetet e pastaj edhe neve si individë, duke u shfaqur në trajta të ndryshme. Korrupsioni, pra efektet e tij i ka edhe në formë të papunësisë, burokracisë, konkurrencës jo të drejtë në treg, e cila rrjedhimisht destimulon hyrjen e bizneseve të reja por edhe operimin e atyre ekzistuese, mungesës së cilësisë së shërbimeve publike qofshin ato në shëndetësi, kulturë, arsim, infrastrukturë etj; vjedhje, pandershmëri, humbje të pasurisë publike, shfrytëzim, mashtrim, skandal, neglizhencë e përgjegjësi etj. Të gjitha këto së bashku sjellin situatën aktuale jo të kënaqshme shoqërore, të cilat në rrënjët e tyre si shkaktar kanë korrupsionin. Pra,

ajo se çfarë ne duhet të arrijmë të kuptojmë është se korrupsioni nuk është si efekt anësor i papunësisë apo problemeve tjera me të cilat po ballafaqohemi si shoqëri, por përkundrazi është shkaktari rrënjësor i këtyre problemeve.

Përderisa ka shumë institucione që luftojnë korrupsionin, sfida kryesore mbetet bashkimi i përpjekjeve për ta luftuar atë, bashkëpunimi në mes të institucioneve dhe aktorëve të përfshirë në luftën kundër korrupsionit, një sërë nismash anti-korrupsion, përgjegjshmëria institucionale dhe integriteti në vend janë në zhvillim e sipër.

Fenomeni i korrupsionit është një ndër më shqetësuesit në shoqërinë mbarë globale. Duke shfrytëzuar terrenin e një shoqërie demokratike, ky virus e zhyt shoqërinë duke mos e lejuar të kapërcejë në trampolinat e zhvillimit human e demokratik.

Është e rëndësishme të kuptuarit mirë të këtij definicioni, sepse në shumë raste mund të anashkalohet kuptimi i tij i vërtetë, duke u deformuar e duke marrë trajta të tjera, kjo për arsye se ka një prirje nga ana e publikut shqiptar që të përfshijë në konceptin e "korrupsionit" edhe dukuri të cilat nuk janë të tilla. Për të analizuar sjelljen e shoqërisë karshi këtij problemi duhen pasur parasysh disa situata, të cilat çojnë në një tjetër tezë: "Sa te varur jemi ne nga korrupsioni"? Kjo nënkupton se shpeshherë ne jemi viktimat apo inicializuesit e tij?

Duke u bazuar në një sondazh të vitit 2019, kur gjykojnë të dy palët e përfshira në një transaksion korruptiv, shqiptarët tregohen më tolerantë kundrejt "dhënësve" të ryshfetit dhe më të ashpër kundrejt "marrësve". Një nxënës i cili i jep një dhuratë mësuesit të tij me shpresën se do të marrë një notë më të mirë është vlerësuar ose i pa korruptuar (35.4%) ose i justifikuar (34.7%). Pjesa dërrmuese, që janë viktimat të korrupsionit, qëndrojnë indiferentë, duke refuzuar t'i japin zgjidhje këtij problemi të vjetër sa vetë njerëzimi. Arsyeja kryesore që ky fenomen ka ekzistuar dhe është akoma i pranishëm në shoqëri është se shkaqet që çojnë në zhvillimin e këtij fenomeni nuk kanë arritur të eliminohen tërësisht, pavarësisht zhvillimeve që kanë ndodhur me kalimin e kohës.

Hapi i parë për krijimin një shoqërie të shëndetshme është rritja e shkallës së ndërgjegjësimit kolektiv

mbi shkaqet si dhe pasojat e korrupsionit në shoqëri. Gjithashtu, është e paevitueshme ndihma e qeverisë në ndikimin e uljes së nivelit të korrupsionit, kjo duke rritur transparencën me qytetarët, ndëshkimin me ligj të iniciatorëve të korrupsionit, arritjen e një stabiliteti ekonomik. Pra, hallka kryesore për reduktimin e këtij fenomeni është zbatueshmëria me përpikëri e legjislacionit nga ana e gjithsecilit. Kjo do të ndikojë, gjithashtu, në rritjen e shkallës së integriteti ekonomik, politik e social të vendit tonë, në rajon e më gjerë. Prandaj indiferenca nuk është përgjigje!

Detyra jonë si individë është të ndihmojmë në prosperitetin e vendit tonë, arritjen e një stadi më të lartë të mirëqenies dhe sigurimin e një të ardhmeje me të shëndetshme për brezat pasardhës.

Korrupsioni është një sfidë e madhe për demokracinë dhe sundimin e ligjit. Ai rezulton në vendime dhe shpërndarje të burimeve që nuk pasqyrojnë interesat e publikut dhe përqendrojnë fuqinë politike në duart e pak personave. Kjo nga ana tjetër bën që udhëheqësit dhe institucionet politike të humbasin legjitimitetin dhe besimin publik, gjë që zvogëlon aftësinë e tyre për të qeverisur.

Sipas Raportit të Progresit të Komisionit Europian 2020 për Shqipërinë (që mbulon periudhën kohore maj 2019 - tetor 2020), vendi ka përparuar mjaft mirë në luftën kundër korrupsionit. Autoritetet shqiptare përforcuan kapacitetet operacionale, koordinuese dhe monitoruese në luftën kundër korrupsionit, duke plotësuar kështu kushtin për Konferencën e parë Ndërqeveritare. Shqipëria ka vazhduar përpjekjet për krijimin e historikut të plotë në hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e rasteve të korrupsionit. Megjithatë vetingu i anëtarëve të gjyqësorit është proces administrativ, është e rëndësishme të vlerësohen rezultatet konkrete të Shqipërisë për të luftuar korrupsionin. Ndërkohë që numri i hetimeve në vazhdim mbetet i lartë, deri më sot, dënimet përfundimtare në çështjet që përfshijnë zyrtarët e lartë mbeten ende të kufizuara. Organet e sapokrijuara të specializuara kundër korrupsionit (SPAK- Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Gjykata e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar) priten të forcojnë ndjeshëm kapacitetin e përgjithshëm për të hetuar dhe ndjekur penalisht rastet e korrupsionit.

Teknologjia, mani apo zhvillim

Varësia nga celularët është bërë një problem madhor, aq sa të qenit larg tyre na kufizon funksionet tona bazë dhe na bën të ndihemi jo mirë fizikisht, sipas shkencëtarëve. Ky ishte një ndër studimet e para që konstatoi se çfarë i ndodh njerëzve që janë të ndarë nga celularët dhe zbulimet nuk ishin aspak të favorshme për ne.

ANJEZA MUSOLLARI,
SHEFE E SEKTORIT TË BOTIMEVE

Teknologjia, mani apo zhvillim

Teknologjia është një koncept i gjerë që merret me aplikimin e njohurive për veglat dhe profesionet, në funksion të kontrollimit dhe përshtatjes së rrethanave në ambientin jetësor në përputhje me nevojat e tij.

Bota e sotme po ecën me hapa galopantë, por së bashku me zhvillimin teknologjik po shtohen edhe problemet që u vijnë njerëzve nga përdorimi i shumtë i celularëve dhe internetit. Probleme shëndetësore, por edhe sjellje antishoqërore, këto janë disa nga pasojat negative të teknologjisë. Disa studime të fundit e kanë lidhur celularin me probleme të jetës së përditshme si shpërqendrimi, rreziku shëndetësor dhe probleme me gjumin.

Por a është vërtetë kaq i dëmshëm për shoqërinë dhe shëndetin celulari?

Një nga studimet e publikuara këtë javë ka zbuluar se nëse nuk e kemi celularin me vete ose pranë, kjo na bën më pak të përqendruar, rrit presionin e gjakut dhe na bën të ndihemi pa qejf. Varësia nga celularët është bërë një problem madhor, aq sa të qenit larg tyre na kufizon funksionet tona bazë dhe na bën të ndihemi

jo mirë fizikisht, sipas shkencëtarëve. Ky ishte një ndër studimet e para që konstatoi se çfarë i ndodh njerëzve që janë të ndarë nga celularët dhe zbulimet nuk ishin aspak të favorshme për ne. Sipas përfundimeve, ne kemi performancë të ulët në detyrat mendore pa mjetin teknologjik që e kanë shumica e njerëzve në planet.

Teknologjia tek të rinjtë

Teknologjia, tashmë është një pjesë e pandarë e jetës sonë, e cila përdoret jashtëzakonisht shumë, sidomos nga të rinjtë. Megjithatë teknologjia është një fushë mahnitëse, një fushë e cila na habit me informacionet e larmishme të saj, nga të rinjtë po keqpërdoret dhe po keqpërdoret. Sot për shumë të rinj nuk ekzistojnë më ditarët, ku tregonin çdo gjë që ndodhte në jetën e tyre, sot nuk po u kushtohet vëmendja e duhur familjes apo miqve të ngushtë, gjithashtu edhe shumë gjëra të tjera të rëndësishme janë harruar, pasi çdo gjë, si momentet më të bukura, shqetësimet, problemet etj., i kalojnë nëpërmjet teknologjisë, pra nëpërmjet telefonave apo kompjuterëve, ku përdorim të gjerë kanë rrjetet sociale.

Si po ndikon teknologjia në jetën sociale?

Një studim i kryer nga disa psikologë ka zbuluar se teknologjia e sotme kthen një nga përdoruesit e vet në antishoqëror dhe narcizist. Në të gjithë botën, kërkuesit kanë zbuluar se rreth 182 milionë prej nesh janë të varur nga përdorimi i internetit. Teksa web-i bëhet gjithnjë e më i përhapur, është shfaqur nevoja për studime serioze mjekësore në lidhje me çrregullimet që vijnë prej internetit.

Fëmijët në grackën e teknologjisë

"Fëmijës i duhet dhënë ajo që i duhet, jo ajo që kërkon", kjo është një shprehje e Sami Frashërit e cila zë vend në realitetin e sotëm ku fëmijët po bëhen gjithmonë e më shumë pjesë e ambientit virtual. Mënyra e jetës, por edhe ambienti jonë ka ndryshuar shumë në dhjetëvjeçarin e fundit. Është shtuar trafiku rrugor dhe dendësia e ndërtimit, duke bërë që aktiviteti fizik dhe mendor i fëmijëve të jetë pothuajse i vdekur.



Zhvillimi i teknologjisë ka bërë që fëmijët të rriten në një ambient virtual duke marrë për bazë edukative të gjitha informacionet e pakontrolluara që i ofron teknologjia.

Interneti, televizioni, media

1. Televizioni nuk duhet të zëvendësojë nevojën e fëmijës për sport dhe lëvizje.

2. Televizori nuk ka vend në dhomën e fëmijëve.

3. Emisionet për fëmijë duhet të kufizohen dhe të kontrollohen nga prindërit.

4. Është shumë e rëndësishme që prindërit të diskutojnë me fëmijët e tyre rreth atyre që shohin në televizor.

5. Edhe emisionet parapërgatitore për shkollë mund të jenë ndonjëherë të dëmshme për fëmijë të një moshe të caktuar, pasi mbingarkojnë trurin e tyre të njomë me informacione të vështira për t'u kuptuar.

Deri në moshën 18 vjeç të rinjtë janë të dhënë pas atij që quhet konsum mediatik, duke qenë më tepër të ekspozuar ndaj televizorit dhe internetit. Por ajo që është kthyer në një fenomen dhe shqetësim për prindërit dhe specialistët janë video lojërat ose siç quhen ndryshe lojërat kompjuterike. Për këtë çështje ka disa qëndrime. Disa hulumtues mendojnë se video-lojërat ndikojnë në rritjen e inteligjencës dhe përmirësimin e notave të fëmijëve. Ndërsa të tjerë thonë se ato kanë një sërë pasojash negative, si një qëndrim të keq të trupit, probleme në komunikim në mjedisin e tyre, izolim social, obezitet, ekspozimi ndaj dhunës etj. Kjo problematikë është globale. Në shumë shtëpi por edhe në internet-kafetë shqiptare sheh fëmijë dhe të rinj që kalojnë kohën më të madhe duke luajtur lojëra kompjuterike.

Statistika sipas Fondacionit Kaiser Family (KFF)

Dy të tretat e foshnjave dhe të vegjëlvë shikojnë TV me një mesatare prej 2 orësh në ditë. Fëmijët nën moshën gjashtë vjeçare shikojnë mesatarisht rreth 2 orë në ditë në ekran, kryesisht TV, video ose DVD.

Fëmijët dhe adoleshentët e moshës 8-18 vjeç shpenzojnë gati 4 orë në ditë para ekranit televiziv dhe gati 2 orë shtesë në kompjuter duke luajtur video-lojëra

Problematikat që hasin të rinjtë sot:

- Shkolla, lënia e mësimeve pas dore
- Krijim konfliktesh (sherre)
- Pagjumësia
- Mos lexim i librave
- Lojërat-harxhim i kohës
- Vepra kriminale

Në shumë shkolla shqiptare po humbet pak e nga pak vëmendja e nxënësve ndaj mësimeve dhe një nga shkaqet për këtë mbetet përqendrimi i tyre në rrjetet sociale. Sado të përpiqen mësuesit në shkolla për mos lejimin e përdorimit të telefonave në orën e mësimit, këta të rinj përsëri e gjejnë mënyrën për t'i përdorur ata.

Krijimi i konflikteve

Një burim mjaft i rëndësishëm i ekspozimit të shumë të rinjve në sherre të ndryshme mbetet "facebook- u". Në shumë raste, shumë prej tyre përdorin fjalë ofenduese me njëri-tjetrin, duke përdorur mesazhet apo komentet dhe më pas e vijojnë zënkën deri në përleshje, ku në rastin më të keq arrijnë deri aty sa mund të përdorin "armë të ftohta".

Pagjumësia

Ora mund të shkojë 24:00, 01:00 apo edhe 04:00 dhe shohim se shumë të rinj qëndrojnë ende në rrjetet sociale. Por pse? A mund të ketë vallë punë shumë të rëndësishme një fëmijë 13-14 vjeçar, aq sa qëndron deri në orët e vona të natës?! Sigurisht që jo! Ky fiksim i të qëndruarit online deri në këto orë të vona shkakton probleme serioze të shëndetit dhe gjithashtu sindromën e pagjumësisë e cila zhvillohet nga reduktimi i orëve të gjumit.

Braktisja e librave

Një gjë tjetër e keqe që mund t'i bësh librit përveçse ta grisësh, është mos-leximi i tij. Sot termi "libër" mbetet një term i harruar nga të rinjtë. Por sa gjë negative dhe e dëmshme mbetet kjo për shoqërinë tonë?

Lojërat elektronike, kohë e shkuar dëm

Fatkeqësisht sot shohim se shumë fëmijët e harxhojnë kohën duke luajtur lojëra të ndryshme si "counter-strike", "vice-city" etj. Por sa gjëra të bukura mund të bënin ata gjatë kësaj kohe? Ata mund të lexonin, mësonin dhe mund të bënin shumë aktivitete sportive që do të ndihmonin në shëndetin e tyre, si atë fizik ose mendor.

Veprat kriminale

Nëpërmjet rrjeteve sociale ndodhin shumë vepra të ndryshme kriminale si vjedhje ose më keq, vrasje, dhe duhen marrë gjithmonë seriozisht. Nuk janë të pakta rastet kur vajza të vogla janë gënjer me anë të rrjeteve sociale dhe kanë përfunduar në duar të prostitucionit ose abuzimit seksual.

Të përqafosh zhvillimin teknologjik

Bota është gjithnjë në lëvizje,

ndryshim dhe kërkim për përsosje të vazhdueshme. Jetojmë në erën e teknologjisë, e ardhmja i përket asaj. Njeriu synon përmirësimin e jetës së tij dhe kjo mund të arrihet vetëm nëpërmjet ndryshimit. Të gjitha argumentet e mësipërme dëshmojnë se e ardhmja i takon teknologjisë. Nuk na mbetet gjë tjetër veç të ndjekim ritmin e ndryshimit, me kujdesin ndaj të miturve dhe vigjilencën për të panjohurën.

Teknologjia është shumë e rëndësishme dhe gati e pazëvendësueshme për njeriun modern, por ajo mbart edhe efekte negative në jetën e njeriut dhe shoqërisë. Një ndër to është edhe ekspozimi i tepërt i fëmijëve 0-3 vjeç ndaj teknologjisë. Shpesh herë fëmijët shqiptarë që përdorin teknologjinë dëgjojnë video-animatore në gjuhën angleze. Ka një pjesë të fëmijëve që i zhvillojnë të dyja gjuhët në mënyrë simultane dhe këtu jemi në rregull. Fëmijët që zhvillojnë dy gjuhë njëkohësisht kanë më tepër avantazhe se një fëmijë që përdor vetëm një gjuhë, por në këtë artikull do të merremi çrregullimin e dygjuhësisë. Duke qenë se ata jetojnë në një mjedis ku flitet shqip, kjo i bën ata të rrezikuar ndaj çrregullimit të bilingualizmit. Pra, fëmijëve që janë të ekspozuar në dy ose më shumë gjuhë mund t'u ndodhë konfuzioni bilingual ose multilingual dhe, për pasojë, këta fëmijë kanë vështirësi në zhvillimin gjuhësor në secilën gjuhë. Edhe në gjuhën shqipe ata hasin vështirësi, sepse duke qëndruar për një kohë të gjatë me teknologjinë, ata dëgjojnë në gjuhë të huaj e për rrjedhojë ajo nuk është më një e gjuhë e huaj për fëmijën, por ajo kthehet në një gjuhë familjare.

Është një gjuhë e dytë, por kryesore për fëmijën. Sa më tepër të konsumojë kohë me gjuhën e huaj, aq më të mëdha janë gjasat që ai të zhvillojë atë gjuhë, e nga ana tjetër të ketë vështirësi në zhvillimin e gjuhës shqipe.

Por, mund të mos zhvillojë asnjërën e për rrjedhojë ai mund të mbyllet në vetvete prej pamundësisë së komunikimit, prej faktit se është mësuar të rrijë vetëm me teknologjinë që i është dhënë prej familjarëve të vet.

Përmbajtje të medias mund të kontribuojë me shpejtësi të lartë në deficite të vëmendjes, si dhe zvogëlim të përqendrimit dhe kujtesës, për shkak të shkurtimit neuronal në korteksin frontal të trurit. Fëmijët të cilët nuk mund të kenë vëmendje nuk mund të mësojnë.



Në kuadër të Takimit të liderëve të Konferencës së Sigurisë së Mynihut, i cili u mbajt në Washington D.C, Presidentja Osmani ishte folëse kryesore në tryezën me temë: Bashkëpunimi Transatlantik për Sigurinë Energjetike.

Lufta në Ukrainë e ka ekspozuar rrezikun e Rusisë ndaj Europës për sa i përket sigurimit të furnizimit me energji. Distancimi nga gazi, qymyri e nafta ruse është bërë pjesë e sanksioneve të shumë vendeve europiane ndaj Rusisë.

Përballë këtyre zhvillimeve, Presidentja Osmani theksoi se sfidë madhore mbetet gjetja e ekuilibrit të duhur midis përgjigjeve afatshkurtra ndaj krizës aktuale energjetike pa kompromentuar qëllimet dhe ambiciet e tranzicionit të energjisë dhe veprimit klimatik, përderisa sigurohemi që tranzicioni të jetë i drejtë dhe i barabartë.

Duke folur për rëndësinë e bashkëpunimit transatlantik në ballafaqim me krizën energjetike, të ndryshme në të dy anët e Atlantikut, ajo u shpreh se: "qëllimet tona janë të përbashkëta: siguri i furnizimit të rregullt me çmime të arsyeshme dhe të përballueshme nëpërmjet promovimit të politikave të qëndrueshme, mbështetjes së inovacionit dhe arritjes së



Osmani: Bashkëpunimi transatlantik është kyç për garantimin e sigurisë energjetike

objektivave në luftimin e ndryshimeve klimatike".

Teksa foli për mundësinë e ballafaqimit me mungesë të furnizimit të rregullt, sfida ekonomike, tronditje të tregjeve energjetike, dhe rritje të çmimeve të energjisë, presidentja Osmani theksoi se përballë tiranisë, asnjë çmim nuk është shumë i lartë për t'u paguar për të mbrojtur demokracitë dhe për të mbrojtur lirinë.

Në Shtetet e Bashkuara, presidentja Osmani dhe përfaqësues të shteteve të tjera pjesëmarrës

të Konferencës u mbledhën për të diskutuar rreth situatës së sigurisë në Europë pas agresionit rus në Ukrainë dhe forcimin e partneritetit transatlantik.

Kjo konferencë bashkoi dhjetëra vendimmarrës dhe ekspertë të lartë nga të dy anët e Atlantikut për të diskutuar se si partnerët transatlantike mund të ndërtojnë një aleancë më të qëndrueshme dhe të avancojnë bashkëveprimin dhe udhëheqjen e përbashkët në sfidat e sigurisë, duke përfshirë luftën aktuale në Ukrainë.

Gjithashtu në hapjen zyrtare të takimit të liderëve të Konferencës së Mynihut e cila sivjet u mbajt në Washington D.C, presidentja e Kosovës Vjosa Osmani takoi zyrtarë të administratës amerikane, kongresistë e senatorë, zyrtarë europianë, ministra nga shtete të ndryshme si dhe përfaqësues të "think- tanks" nga Amerika e Europa.

Në takim me këshilltarin për Siguri Kombëtare të presidentit Biden, z. Jake Sullivan, presidentja Osmani diskutoi lidhur me situatën në Ballkanin Perëndimor pas invazionit rus në Ukrainë si dhe për sfidat me të cilat po ballafaqohet ky rajon. Ajo falënderoi administratën e presidentit Biden për rolin kyç në mbrojtjen e demokracisë dhe sigurisë në kontinentin tonë, e mbi të gjitha për përkrahjen e jashtëzakonshme që historikisht ia kanë dhënë Kosovës, Shtetet e Bashkuara të Amerikës e në veçanti presidenti Biden.

Presidentja takoi edhe Ministren për Çështje Europiane të Finlandës, Tytti Tuppurainen, me të cilën diskutoi për përgatitjet e Kosovës për aplikim në organizata ndërkombëtare si dhe për reformat e ndërmarra në Kosovë, e të cilat e avancojnë Kosovën në rrugën euro-atlantike.

Në këtë konferencë, presidentja Osmani bashkëbisedoi edhe me ministrin Federal të Gjermanisë Wolfgang Schmidt, ministrin e Punëve të Jashtme të Lituanisë, Gabrielius Landsbergis, senatorin Chris Coons, kongresisten Veronica Escobar, zëvendës Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Mircea Geoana, udhëheqësin e Konferencës së Mynihut ambasadorin Christoph Heusgen, ambasadorin Wolfgang Ischinger, si dhe përfaqësues të tjerë pjesëmarrës në konferencë.

SHBA PËRKRAH ANËTARËSIMIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË NATO

Programi i Partneritetit për Paqe, hap iniciues i Republikës së Kosovës drejt anëtarësimit në NATO

Burime nga Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës, mbi hapat e ndërmarrë drejt anëtarësimit në NATO, nëpërmjet zyrës se shtypit bën me dije se: SHBA, si një ndër partnerët e ngushtë dhe të pazëvendësueshëm në të gjitha proceset zhvillimore të Republikës së Kosovës, përmes përkrahjes së shprehur haptazi nga zëdhënësi i misionit të SHBA-së në NATO, Jeffrey Adler, rreth iniciativës së Republikës së Kosovës për t'u bërë anëtarë të programit të Partneritetit për Paqe, si hap iniciues drejt anëtarësimit në NATO, po e dëshmon se Kosova konsiderohet partner i besueshëm i SHBA-së, "Defender Europe '23", si misionet e përbashkëta, janë rruga jonë drejt qëllimeve tona përfundimtare, anëtarësimin në institucione europiane dhe euroatlantike.

"Rruga jonë është e pashkëputshme nga aleatët tanë, rrugëtimi ynë është i drejtë ngase ndajmë të njëjtat vlera të demokracisë, paqes dhe stabilitetit për të cilat dhe angazhohemi. Republika e Kosovës është e përgatitur për të thelluar partneritetin dhe aleancën tonë e cila shtrihet në shumë fusha, bazuar mbi vlerat e përbashkëta me SHBA-në dhe është e përkushtuar në rrugën e saj të integritetit në NATO dhe Bashkimin Europian", -tha Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës, nëpërmjet një postimi të saj.



Finlanda dhe Suedia dorëzojnë aplikimet për t'u anëtarësuar në NATO

Stoltenberg: Ky është një moment historik që duhet ta shfrytëzojmë

MSC. MIMOZA GOLIKJA

Finlanda dhe Suedia, dorëzuan njëkohësisht letrat e tyre zyrtare të aplikimit për t'u anëtarësuar në NATO në mëngjesin e të mërkurës të 18 majit 2022. Letrat iu dorëzuan Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg në selinë e Aleancës në Bruksel nga ambasadori finlandez në NATO Klaus Korhonen, dhe ambasadori suedez në NATO Axel Wernhoff. Z. Stoltenberg i mirëpriti ngrohtësisht kërkesat, "kjo është një ditë e mirë, në një moment kritik për sigurinë tonë", -tha ai.

"Ambasadore, i dashur Klaus, i dashur Axel, miq të dashur, kjo është një ditë e mirë, në një moment kritik për sigurinë tonë. Faleminderit shumë për dorëzimin e aplikimeve për anëtarësimin e Finlandës dhe Suedisë në NATO. Çdo komb ka të drejtë të zgjedhë rrugën e tij. Ju të dy kombet e keni bërë zgjedhjen tuaj, pas proceseve të thella demokratike dhe unë mirëpres ngrohtësisht kërkesat e Finlandës dhe Suedisë për t'u anëtarësuar në NATO. Ju jeni partnerët tanë më të afërt dhe anëtarësimi juaj në NATO do të rriste sigurinë tonë të përbashkët", -tha në fjalën e tij në një konferencë shtypi, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, para të pranishmëve dhe së bashku me Klaus Korhonen (ambasador

i Finlandës i akredituar në NATO) dhe Axel Wernhoff (ambasador i Suedisë i akredituar në NATO).

"Aplikimet që keni bërë sot janë një hap historik. Aleatët tani do të shqyrtojnë hapat e ardhshëm në rrugën tuaj drejt NATO-s. Interesat e sigurisë së të gjithë aleatëve duhet të merren parasysh dhe ne jemi të vendosur të punojmë me të gjitha çështjet dhe të arrijmë në përfundime të shpejta", -tha Stoltenberg dhe nënvizoi se "gjatë ditëve të fundit, ne kemi parë deklarata të shumta nga aleatët që angazhohen për sigurinë e Finlandës dhe Suedisë". "NATO është tashmë vigjilente në rajonin e Detit Baltik dhe forcat e NATO-s dhe aleatëve do të vazhdojnë të përshtaten sipas nevojës, -tha ai, -nëse të gjithë aleatët bien dakord për rëndësinë e zgjerimit të NATO-s", -theksoi Jens Stoltenberg. "Të gjithë jemi dakord që duhet të qëndrojmë së bashku dhe të gjithë jemi dakord se ky është një moment historik, të cilin duhet ta shfrytëzojmë", -tha Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s.

Finlanda dhe Suedia aplikojnë për anëtarësim në NATO

"Aleanca ushtarake është e gatshme të shfrytëzojë momentin historik që në një proces të përshpejtuar të lejojë Finlandën dhe Suedinë të jenë pjesë e aleancës, pasi të dy vendet paraqitën kërkesat e tyre për

anëtarësim. Por aplikimet zyrtare, të dorëzuara nga ambasadorët e Finlandës dhe Suedisë në NATO, vijnë mes paralajmërimeve të Rusisë se një veprim i tillë, nuk është i mirëpritur dhe se mund të pasohet me një kundërpërgjigje. Presidenti rus Vladimir Putin nga ana e tij ka kërkuar ndërprerjen e zgjerimit të aleancës pranë kufijve të Rusisë, ndërsa disa aleatë të NATO-s, të udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara dhe Britania, kanë dhënë tashmë shenja se janë të gatshëm të ofrojnë mbështetje sigurie për Finlandën dhe Suedinë, nëse Rusia përpaket t'i provokojë, ose destabilizojë ato, gjatë kohës së shqyrtimit të kërkesës. Vendet përfitojnë nga garancia e sigurisë e nenit 5 të NATO-s, që thotë se çdo sulm ndaj një anëtari konsiderohet si një sulm ndaj të gjithë anëtarëve, pasi të përfundojë ratifikimi i aplikimeve, ndoshta pas disa muajsh", -tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg.

Ky veprim është një nga ndryshimet më të mëdha gjeopolitike që do të rishkruajë hartën e sigurisë së Europës. Kryeministri britanik Boris Johnson gjithashtu mirëpriti aplikimet. Në një postim në Twitter ai tha se ambiciet e tmerrshme të Putinit kanë transformuar vijat gjeopolitike të kontinentit të Europës. Procesi i shqyrtimit të kërkesës pritet të zgjasë rreth dy javë, megjithëse presidenti turk Recep Tayyip Erdogan ka shprehur rezerva rreth anëtarësimit të vendeve nordike.



Erdogan deklaroi se nuk mund të lejojë anëtarësimin e tyre për shkak të mbështetjes që ai thotë se këto vende u japin militantëve kurdë dhe grupeve të tjera që Ankaraja thotë se kërcënojnë sigurinë e saj kombëtare. E nëse tejkalohen kundërshtimet e Turqisë dhe bisedimet e anëtarësimit shkojnë siç pritet, të dy vendet mund të bëhen anëtarë të NATO-s së shpejti.

Opinioni publik në Finlandë dhe Suedi ka ndryshuar qëndrim rreth anëtarësimit në NATO, që kur Rusia sulmoi Ukrainën më 24 shkurt. Finlanda dhe Suedia bashkëpunojnë shumë ngushtë me NATO-n. Të dy vendet kanë demokraci funksionale, forca të armatosura të mirë financuara dhe kontribuojnë në operacionet ushtarake të aleancës dhe misionin për kontrollin ajror.

Pas mbi 200 vitesh, Suedia heq dorë nga qëndrimi neutral ushtarak

Qeveria e Suedisë mori vendimin zyrtar të hënën, më 16 maj 2022 për të paraqitur kërkesën për anëtarësim në NATO, duke ndjekur hapat e fqinjit të saj Finlandës, në një lëvizje që do ta ndryshojë hartën gjeopolitike të Europës veriore. Vendimi i Suedisë për të bërë kërkesën për

anëtarësim në NATO vjen pas më shumë se 200 vitesh të një qëndrimi neutral ushtarak, vendim që shqetësoi presidentin rus Vladimir Putin.

"Qeveria ka vendosur të informojë NATO-n se Suedia dëshiron të bëhet anëtare e aleancës", -tha të hënën kryeministria suedeze Magdalena Andersson. Njoftimi erdhi pas një debati në parlamentin suedez, ku pati një mbështetje të madhe për anëtarësimin e vendit në NATO. Nga tetë partitë e Suedisë, vetëm dy parti më të vogla të majta e kundërshtuan qëndrimin e qeverisë. Më tejherë Shtetet e Bashkuara thanë se mirëpresin deklaratat e Finlandës dhe Suedisë mbi synimin e tyre për të kërkuar anëtarësimin në NATO. "Ne do t'i mbështesim fuqimisht kërkesat e tyre kur ato të paraqiten zyrtarisht në Bruksel, por Finlanda dhe Suedia janë partnerë të ngushtë dhe të vlerësuar të mbrojtjes për Shtetet e Bashkuara dhe NATO-n", -tha Sekretarja e Shtypit e Shtetësisë së Bardhë, Karine Jean-Pierre. Nga ana tjetër diplomatët e lartë të NATO-s u takuan të dielën në Berlin për të diskutuar mbështetjen e mëtejshme për Ukrainën dhe planet e Finlandës dhe Suedisë për t'u anëtarësuar në aleancën më

të madhe ushtarake në botë, e cila ka furnizuar Ukrainën me armë gjatë gjithë luftës. "Në takimin me aleatët në Berlin morën pjesë edhe ministrat e Jashtëm të Suedisë dhe Finlandës. Të dy vendet janë partnerë të ngushtë dhe të vlefshëm të NATO-s dhe Shteteve të Bashkuara, dhe Uashingtoni do të mbështesë fuqimisht anëtarësimin e Suedisë dhe Finlandës në NATO, nëse ato zyrtarisht vendosin ta bëjnë këtë", -tha Sekretari amerikan i Shtetit Antony Blinken atë ditë. Dhe vetëm të martën në mëngjes, më 17 maj, ministria e Jashtme e Suedisë Ann Linde do të nënshkruante aplikimin që deklaronte se "vendi dëshiron të anëtarësohet në NATO". Kjo lëvizje politike ushtarake shënoi kështu një hap zyrtar nga Stokholmi drejt bashkimit me aleancën ushtarake të NATO-s, duke i dhënë fund dekadave të neutralitetit ushtarak, pasi pushtimi rus i Ukrainës ndezi një evolucion dramatik në sigurinë dhe gjeopolitikën europiane. "Kemi arritur në një përfundim që është më i miri për Suedinë", -tha ministria Linde.

Ndërkohë Finlanda që ndan një kufi 1 300 kilometra të gjatë me Rusinë, vetëm para pak ditësh dhe pikërisht të dielën, më 15 maj 2022, do

të njoftonte zyrtarisht synimin e saj për anëtarësim në NATO, edhe pse Presidenti rus Vladimir Putin tha se anëtarësimi i Finlandës në NATO do të ishte veprim i gabuar. Por megjithatë Presidenti i Finlandës foli me Putin para njoftimit zyrtar të anëtarësimit dhe tha se ishte i befashuar nga qetësia me të cilën ai e priti lajmin për planin e Finlandës për t'u anëtarësuar në NATO. "Situata tani ka ndryshuar. Ne do të fillojmë procesin e anëtarësimit në NATO. Putini, gjithashtu konfirmoi se ai mendon se ky është një gabim. Por tha se "Nuk po ju kërcënojmë". "Në përgjithësi, diskutimi ishte i qetë dhe i ftohtë", -tha Presidenti i Finlandës, Sauli Niinistö.

"Qëndrimi i tanishëm i Suedisë dhe Finlandës për të aplikuar për anëtarësim në NATO dhe përgjigjja nga aleatët që kjo të shqyrtohet dhe përmbushet menjëherë është një shenjë e qartë se NATO ka mësuar nga gabimet e saj politike", -do të shprehej zëvendëskryeministria e Ukrainës Olga Stefanishyna.

Aplikimi i Finlandës dhe Suedisë, përse i dërrhet Turqia anëtarësimit në NATO të vendeve nordike?

Vetëm disa orë pasi Finlanda dhe Suedia paraqitën kërkesën e tyre për anëtarësim në NATO, duhej marrë vendimi për të nisur procesin e anëtarësimit të nevojshëm për këtë qëllim u duk se Turqia e frenoi këtë plan dhe bllokoji vendimin. Turqia tha se kërkonte veton ndaj pranimi të dy vendeve. Që Suedia dhe Finlanda të jenë pjesë e aleancës ushtarake, të gjithë anëtarët e saj duhet të miratojnë anëtarësimin e tyre. Por Turqia ka ngritur shqetësimet e veta të sigurisë dhe ka bërë kërkesa për dy kandidatët për anëtarësim.

Presidenti turk Recep Tayyip Erdogan nga ana e tij duket se po pengon përpjekjet e Suedisë dhe Finlandës, të cilat morën vendi-

min historik për të kërkuar hyrjen në NATO. Ai deklaroi se nuk mundet të lejojë anëtarësimin e tyre për shkak të mbështetjes që ai thotë se u japin militantëve kurdë dhe grupeve të tjera që Ankaraja thotë se kërcënojnë sigurinë e saj kombëtare. Në një fjalim drejtuar partisë së tij islamo-konservatore në pushtet, AKP, në Ankara, Erdogan riafirmoi qëndrimin e tij. Zgjerimi i NATO-s me këto dy anëtarë, për Turqinë ka lidhje me respektimin e ndjeshmërisë së saj, theksoi kreu i shtetit turk. Ai kritikoi Suedinë dhe Finlandën se duan të mos heqin dorë nga mbështetja e tyre për "organizatat terroriste" në të ardhmen. Ai përsëri kritikoi Suedinë për refuzimin e ekstradimit të "terroristëve" dhe vuri në dukje: "NATO është një aleancë sigurie, një organizatë sigurie. Në këtë kuptim, nuk mund t'i themi po bërjes së pasigurt të këtij organi të sigurisë".

Turqia, vendi që ka ushtrinë e dytë për nga madhësia në NATO, ka qenë tradicionalisht në mbështetje të zgjerimit të NATO-s, me besimin se politika e dyerve të hapura forcon sigurinë europiane. Turqia është shprehur p.sh. në favor të një perspektive anëtarësimi për Ukrainën dhe Gjeorgjinë. Kundërshtitë e presidentit turk Erdogan për Suedinë dhe Finlandën burojnë nga pakënaqësitë e Turqisë me Stokholmin, dhe më pak me Helsinkin, për mbështetjen që mendon se i jep Partisë së Punëtorëve të Kurdistanit (PKK), e shpallur e jashtëligjshme në Turqi, si dhe grupit të majtë ekstremist DHKP-C, dhe mbështetësve të klerikut mysliman me qëndrim në Shtetet e Bashkuara, Fethullah Gulen, për të cilin Ankaraja thotë se orkestroi puçin e dështuar ushtarak në vitin 2016. Shumë kurdë dhe azilantë të tjerë kanë gjetur strehë në Suedi gjatë dekadave të fundit. Atyre iu janë shtuar rishtazi edhe anëtarët e lëvizjes Gulen. Duke justifikuar

kundërshtimin e tij, presidenti Erdogan thotë se vendi i tij nuk duhet të bëjë përsëri "gabimin" që bëri Ankaraja kur ra dakord të ripranohej Greqia në strukturën ushtarake të NATO-s, në vitin 1980. Ai thotë se kjo i mundësoi Greqisë "të mbante një qëndrim kundër Turqisë" me mbështetjen e NATO-s. Nga ana tjetër Turqia kërkon të bëhet sërish pjesë e programit të avionëve ushtarakë F-35 që udhëhiqet nga SHBA. Ajo u përjashtua nga programi pasi bleu sistemet ruse të mbrojtjes me raketa S-400. Nëse nuk bëhet dot pjesë e programit për avionët F-35, Turqia dëshiron të blejë një seri të re avionësh luftarakë F-16 për të përmirësuar forcat e saj ajrore. Kërkesat e tjera mund të përfshijnë dhënien fund të një embargoje jozyrtare ndaj armatimeve që aleatët i shesin Turqisë; koncesione nga vendet anëtare të BE-së për aplikimin e pasuksesshëm të Turqisë për anëtarësim; si dhe fonde të mëtejshme për ta ndihmuar vendin që të mbështesë 3.7 milionë refugjatët sirianë.

Por Turqia nga ana tjetër gjithashtu ka krijuar një imazh të mirë duke furnizuar Ukrainën me dronët luftarakë "Bayraktar TB2", të cilët u bënë një armë efikase kundër forcave ruse dhe kjo lëvizje do ta cenonte këtë imazh. Dhe Turqia gjithashtu ka krijuar marrëdhënie të ngushta me Rusinë dhe me Ukrainën dhe është përpjekur t'i ruajë të balancuara këto lidhje. Turqia nuk i është bashkuar sanksioneve ndaj Rusisë, ndërkohë që e mbështet Ukrainën me dronët që ia ndaluan Rusisë të fitojë superioritetin në ajër. Ndërkohë Aleanca e NATO-s nuk ka komentuar mbi diskutimet brenda Këshillit të NATO-s lidhur mbi shqetësimet e Turqisë. Por Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg, nga ana e tij ka thënë se është i vendosur për të arritur një zgjidhje të shpejtë për Finlandën dhe Suedinë. "Këto dy vende janë partnerët tanë më të ngushtë dhe bashkimi me NATO-n do të rriste sigurinë euro-atlantike," -tha ai.

Aleatët dhe Shqipëria në Luftën e Dytë Botërore (Në kuadrin e 9 majit, ditës së fitores mbi fashizmin)

Pushtimi fashist dhe njohja e qëndresës së popullit shqiptar

7 prilli 1939 ishte dita e parë e pushtimit fashist, por edhe dita e parë e rezistencës së armatosur anti-fashiste e popullit shqiptar. Pushtimin nga Italia fashiste populli shqiptar e priti me armë në dorë. Megjithëse me një qëndresë të paorganizuar, të pak formacioneve të ushtrisë mbretërore nën mbështetjen e patriotëve dhe vullnetarëve popullorë, kjo rezistencë tregoi se populli shqiptar e urrente fashizmin. Në vitet e para të pushtimit fashist (1939-1941), qëndresa pati kryesisht karakter spontan por, ajo po përgatiste shtratin e shëndoshë për një rezistencë të organizuar për të ardhmen. Krijimi i forcave politike dhe veçanërisht i Frontit NÇ, e cila përqafoi dhe propagandoi idenë e luftës së armatosur kundër pushtuesve bëri që gjatë vitit 1942, veprimtaria e njësiteve guerile dhe çetave partizane po tronditin seriozisht pushtuesit fashist.

Më 16 shtator 1942, u mbajt Konferenca e Pezës, e cila i dha impulse të mëdha lëvizjes dhe qëndresës luftarake kundër pushtuesve të huaj. Platforma e saj pluraliste po jepte shpresat për një bashkim gjithëpopullor në luftë. Krijimi i Frontit Nacionalçlirimtar rriti jo vetëm moralin e popullit shqiptar për luftë, por



njëkohësisht iu tregonte vendet demokratike perëndimore e veçanërisht aleatëve të mëdhenj: SHBA, Angli dhe BRSS, se lëvizja e armatosur në Shqipëri ishte një lëvizje e organizuar dhe e drejtuar. Pas Konferencës së Pezës kemi një rritje të ndjeshme të grupeve dhe njësiteve guerile në qytete por sidomos rritje të veprimtarive të çetave partizane dhe atyre territoriale në zonat fshatare. Kjo situatë e re politike e krijuar në vend dhe veçanërisht veprimet e suksesshme të armatosura fituan simpatinë dhe vëmendjen e

aleatëve të cilët shikonin te lufta për çlirimin e popullit shqiptar një aleat në luftën e përbashkët kundër fuqive nazifashiste të Luftës së Dytë Botërore.

Komanda e përgjithshme e Fuqive aleate në Mesdhe po vlerësonte seriozisht dobinë që do t'i sillte realizimit të objektivave të tyre politiko-ushtarak dhe lëvizja nacionalçlirimtare e popujve të Ballkanit. Në këto kushte, më 18 dhjetor 1942 aleatët e mëdhenj, SHBA, Angli dhe BRSS nëpërmjet ministrave të jashtëm Cordell Hull (SHBA), Molotov (BS) dhe An-

thony Eden (Angli), nënshkruajnë një deklaratë të përbashkët. Me fjalë falënderimi ata vlerësojnë luftën dhe qëndresën e popullit shqiptar duke deklaruar njohjen e Luftës Antifashiste dhe shprehën mbështetjen e saj si pjesë përbërëse e luftës së përbashkët kundër vendeve të bllokut nazifashist. Deklarata Hull-Molodov-Eden përbënte një fitore të madhe për popullin shqiptar. Ajo e rreshtoi vendin tonë në krah të aleatëve të mëdhenj dhe njëkohësisht hodhi poshtë pretendimet se Shqipëria ishte pjesë e boshtit famëkeq nazifashist. Deklarata e fuqive aleate, ngjalli shpresa të mëdha dhe inkurajoi më tepër lëvizjen për çlirim të popullit shqiptar. Pas kësaj forcat aleate filluan aksionet konkrete për marrjen e kontaktit me lëvizjen nacionalçlirimtare shqiptare. Në shtator 1943 Wiston Churchill duke iu përgjigjur pyetjes së një deputeti në dhomën e komuneve deklaroi lajmin se armatat e aleatëve perëndimorë kishin hyrë në kontakt me forcat çlirimtare në Shqipëri. Duke deklaruar se "Oficerët britanik që kanë hyrë në marrëdhënie me guerilët shqiptarë, kanë shfaqë admirim për vetitë e tyre luftarake. Ne presim që shqiptarët duke ndjekë traditat e tyre të lashta, të lozin rolin e tyre për suksesin e operacioneve luftarake në frontin e Mesdheut".

Shtabi i Mesdheut dhe misionet britanike

Edhe pse për herë të parë misioni ushtarak anglez vjen në Shqipëri në verën e vitit 1943, interesimi i anglezëve kishte filluar me herët. Në korrik 1940 Çerçill kishte hedhur idenë "Për të ndezur zjarrin në Europë". Në prill të vitit 1941, rreth 300 shqiptarë nën udhëheqjen e vëllezërve të dëgjuar kosovarë, Kryeziu, monarkistit Abaz Kupi dhe komunistit Mustafa Gjinishi të shoqëruar nga nënkoloneli anglez Okley Hill, shefi i seksionit SO2 në Beograd dhe ish-instruktori i xhandarmërisë në

kohën e mbretit Zog, organizuan një kryengritje kundër italianëve në Shqipërinë e veriut. Për shkak të masave të dobëta organizative kryengritja dështoi por ajo tregoi interesa dhe mbështetjen e anglezëve kundër pushtuesve italianë në Shqipëri.

Interesimi i rritur i anglezëve për rezistencën në Ballkan kishte një arsye tjetër objektive. Nga fundi i vitit 1942, lufta kishte arritur në pikën e kthesës. Në këto rrethana, një grup prej katër ushtarakësh anglezë të kryesuar nga Majori Maclean, i cili kishte pasur një eksperiencë të mirë të luftës guerile në Palestinë dhe Abisini; Kapiteni David Smajli; Togeri xhenier Geri Defi dhe rreshteri me origjinë skoceze Williamson, në pranverën e vitit 1943 hynë në kontakt me Ushtrinë Nacionalçlirimtare në jug të vendit. Takimi i parë u bë nga Bedri Spahiu dhe pas një udhëtimi të gjatë ky mision atashohet pranë Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH. Mbërritja e misionit të parë bëri të mundur që shpejt qeveria angleze të krijojë një tjetër pamje për luftën dhe Lëvizjen Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar. Nga raportet e dërguara prej grupit të oficerëve anglezë të atashuar pranë Ushtrisë Nacionalçlirimtare, Qendra SOE në Londër bënte "përmbledhje dyjavore" (korrik 1943), ku thuhej se "Kemi lajme të mira nga Shqipëria. Shërbimi SOE-së për Shqipërinë është vënë në vijë dhe guerilet shqiptarë janë po aq aktive dhe anti-italiane sa ç' është njoftuar". Njohja nga afër e objektivave të luftës së popullit shqiptar rriti më tej jo vetëm interesimin dhe mbështetjen, por strukturat e misioneve ushtarake angleze u shtuan duke u vendosur jo vetëm pranë Shtabit të Përgjithshëm, por edhe në disa komanda të disa njësive të mëdha të UNÇSH.

Pranë Shtabit të Përgjithshëm gjatë Luftës Nacionalçlirimtare vepruan tre misione britanike. Pavarësisht se fillimisht marrëdhëniet midis misioneve ushtarake angleze

dhe luftës së popullit shqiptar reflektuan ngarkesa politike për shkak të forcave të ndryshme politike që vepronin në vend. Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH-së i mirëpriti këto misione me përzemërsi. Tek këto misione ai shihte mundësinë për mbështetje e furnizime me materiale luftarake për shkak të nevojave gjithnjë e më rritje të formacioneve luftarake partizane, si dhe mbështetjen si një faktor tepër i rëndësishëm politiko-ushtarak siç ishte Anglia në kuadër të aleatëve të mëdhenj së bashku me SHBA-të dhe BRSS. Përputhja e qëllimeve strategjike dhe objektivave të luftës përbënin bazën për një bashkëpunim e bashkëveprim efektiv midis UNÇSH-së dhe komandës së forcave aleate të Mesdheut. Komanda aleate ishte e interesuar që në Ballkan të bllokoheshin sa më shumë forca armike e të krijoheshin sa më shumë zona të lira në thellësi të territoreve apo në bregdet për t'i pasur ato si objekte mbështetëse për operacione zbarkimi në të ardhmen. Veprimet e suksesshme të UNÇSH-së veçanërisht në gjysmën e dytë të vitit 1944 për bllokimin dhe asgjësimin e kolonave gjermane të cilat tërhiqeshin nga Greqia e Veriut, në kuadër të tërheqjes së tyre strategjike nga Ballkani, ishte një ndihmesë e vlerësueshme për forcat aleate. Së bashku me objektivat e Mësymjes së Përgjithshme që UNÇSH zhvilloi prej qershorit deri në nëntor 1944, këto veprimtari të suksesshme ishin në pajtim dhe interes të plotë të objektivave strategjike të aleatëve për Ballkanin perëndimor.

Misioni ushtarak amerikan

Pranë Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare u vendos edhe një mision ushtarak amerikan. Misioni ishte i përbërë nga tre veta dhe drejtohej nga togleri me origjinë shqiptarë Thomas Stefan. Detyra e këtij misioni ishte të vendoste e të mbante ndërlidhje midis UNÇSH dhe Ushtrisë Amerikane, si



dhe të informonte për zhvillimet e luftës e të formacioneve luftarake shqiptare. Shtetet e Bashkuara të Amerikës po i ndiqnin me vëmendje ngjarjet në Shqipëri. Duke vlerësuar këto zhvillime qeveria amerikane nëpërmjet ministrit të saj të Jashtëm Cordell Hull, me rastin e ditës së Flamurit më 1943 i dërgoi popullit shqiptar një mesazh radiofonik ku theksonte: "Qeveria dhe populli i Shteteve të Bashkuara kanë ndjekë me interesim të gjallë luftën e popullit shqiptar për të ruajtë pavarësinë dhe tërësinë tokësore të atdheut të tij.

Ne kemi vëzhguar me simpati dhe admirim rezistencën tuaj kundër invadorit fashist dhe vendosmërinë tuaj për të jetuar të lirë në vendin tuaj". Togeri Thomas Stefan mori pjesë edhe në Kongresin e I Antifashist Nacionalçlirimtar që u mbajt në Përmet në maj 1944, me ftesë të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH.

Shqipëria në pozicion të prerë antifashist

Ndihmesa e popullit shqiptar në krah të Aleatëve të Mëdhenj për fitoren mbi fashizmin dhe kostoja që ai pagoi për këtë është tepër e ndjeshme. Populli shqiptar, nën udhëheqjen e Frontit NÇ, radhitjen

e tij në krah të Aleatëve të Mëdhenj nuk e pa thjesht si një aderim apo solidarizim e aq më pak për ta pasur si një kartë për ta tundur në përfundim të luftës. Në të kundërt, besnik i traditave të të parëve të vet, ai këtë renditje e shikonte dhe e zbatoi, pa as më të voglin hezitim, si një detyrim e angazhim moral e atdhetar për të renditur në frontin e përbashkët gjithë potencialet morale, njerëzore, materiale e luftarake. Dhe ai, në sajë të ndihmesës së çmuar në shkallë ndërkombëtare, arriti me dinjitet ta radhis veten në ballin e qëndresës antifashiste e në krah të fitimtarëve. Ky pozicionim i prerë antifashist ishte njëherazi edhe një ndihmesë në ruajtjen e tërësisë territoriale të shtetit shqiptar të pas luftës, të rrezikuar nga lakmitë e shteteve shovene fqinje. Është ajo luftë dhe sakrifica mbinjerëzore që bënë brezat e shkuar që na japin sot krenarinë kur dëgjojmë që vendi jonë radhitet ndër të parët dhe përfaqësues të tij edhe dekorohen nga të huajt për merita në këtë luftë. Përulemi me respekt ndaj gjithë atyre që bënë LANÇ dhe brezave që përballuan me dinjitet peshën e rëndë të saj.

Është meritë e padiskutueshme e atyre organeve e personaliteteve politike e ushtarake që udhëhoqën LANÇ, të cilët ditën të vendosin e të ruajnë raporte të drejta mes faktorit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar në këtë luftë për jetë a vdekje. Agjencia Rojter, më 1 nëntor 1940, deklaronte se: "...mobilizimi i Shqipërisë dështoi krejtësisht". Dhe kjo nuk erdhi rastësisht apo sikurse vepronin forca të caktuara politike që qëndronin në heshtje apo edhe duke e përkrahur intensivisht pushtuesin e duke iu kundërvënë LANÇ-it. Ishte një veprimtari e tërë e atdhetarëve, komunistëve, fetarëve, rinisë, gruas shqiptare që edhe pse nën terrorin fashist, ditën të organizohen dhe të bëjnë të dështojë çdo përpjekje e tyre por edhe e bashkëpunëtorëve dhe shërbëtorëve besnikë për të kthyer fletën e luftës.

Shqipëria nxori rreth 70 000 luftëtarë të përfshirë në 24 brigada, 8 divizione dhe 3 korparmata. Konferenca historike e Bujanit i dha një zhvillim të madh Lëvizjes NÇ edhe në Kosovë, ku u krijuan 9 brigada partizane dhe rreth 53 000 luftëtarë. Në luftime e operacione të ndryshme në Shqipëri u vranë 28 000 dëshmorë, krahas rreth 20 000 qytetarëve të masakruar, vranë e gjymtuar nga pushtuesit fashistë e nazistë. Në territorin shqiptar shkeli këmba e më së 700 000 trupave nazifashiste dhe u angazhuan rreth 15 divizione italiane e gjermane duke iu nxjerrë jashtë luftimit rreth 70 000 trupa. UNÇSH plotësoi më së miri misionin që mori mbi vete duke çliruar vendin pa qenë e nevojshme që në truallin e saj të futeshin formacione ushtarake të forcave aleate. Kjo përbën, në pamjen luftarake, ndihmesën e drejtpërdrejtë të popullit shqiptar në kuadër të Koalicionit të Madh Botëror Antifashist.

Shqipëria mbajti kështu një peshë të rëndë në raport me popullsinë.

9 Maji, Dita e Europës

EUROPA,

adresa ku na bashkon
historia dhe përkatësia
jonë shpirtërore

Europa ka dy ditë të shënuara, 5 majin, që njihet edhe si dita e Këshillit European dhe 9 majin, që është dita e Bashkimit European dhe ka ngelur nga data kur ministri i Jashtëm francez Shuman, bëri deklaratën e njohur historike. Deklarata e 9 majit 1950 është data kur u hodh hapi i parë drejt krijimit të asaj që sot njihet si Bashkimi European. Ministri i Jashtëm i Francës, Robert Schuman, lexoi për shtypin ndërkombëtar një deklaratë ku i bënte thirrje Francës, Gjermanisë dhe vendeve të tjera europiane për të bashkuar prodhimet e tyre të qymyrit dhe çelikut që do të ishte "themeli i parë konkret për një Federatë të ardhshme Europiane". Vendet të cilave u drejtohej thirrja kishin dalë të rrënuara materialisht dhe moralisht nga konfliktet me njëra tjetrën. Ajo që propozonte Schuman ishte krijimi i një institucioni european mbi-kombëtar, i cili do të administronte indus-





trinë e prodhimit të qymyrit dhe çelikut, sektor i cili në atë kohë ishte baza e fuqisë ushtarake. Për këtë arsye dita e Bashkimit European njihet ndryshe edhe si Dita e Shumanit.

Vite më vonë, në Samitin e Milanos në 1985, krerët e BE-së vendosën që data 9 maj të shpallej dhe festohej si "Dita e Europës". Ajo është një nga simbolet e Europës së Bashkuar.

Parlamenti European e njohu ditën e Europës sërish më 9 maj, në vitin 2008.

Dita e Europës festohet edhe në vendet që nuk janë ende pjesë e BE-së për të theksuar vlerat e këtij unioni, përhapjen e tyre në sistemin e edukimit. 9 maji festohet edhe në Shqipëri. Që nga viti 2003, edhe Ukraina e feston këtë ditë, gjatë një të shtune maji.

Megjithëse është e pranuar gjerësisht si Dita e Europës, ende disa grupe, mendojnë që 5 maji shpreh më mirë vlerat e demokracisë dhe barazisë mes popujve të Europës, ndërsa 9 majin e shohin si ditën e një marrëveshje-

je mes Gjermanisë dhe Francës.

Motoja e BE-së është "Të bashkuar në diversitet".

Himni i BE-së është Himni i gëzimit, "Ode to Joy" e Bethovenit. Europa është fat.

Është zgjedhje dhe zgjidhje. Është më shumë se gjeografi dhe jo më pak se një ëndërr. Europa është mohimi i një të shkuare të zyrtë dhe historia e të ardhmes që pret ende të shkruhet.

Për ne shqiptarët, Europa nuk është qëllim në vetvete, por bindja se europianizimi i Shqipërisë është fati ynë i shkruar, zgjedhja dhe zgjidhja, adresa ku na bashkon historia dhe përkatësia jonë shpirtërore.

E dalë nga tmerri i një lufte botërore që nisi në Europë, atdheu i përbashkët i Shekspirit dhe Da Vinçit, Gëtes dhe Hygoit, Servantesit dhe Kadaresë, shtetarët e saj të mëdhenj, kuptuan të vërtetën e madhe që bashkëjetesa dhe jo agresioni, heqja e kufijve dhe vendosja përfundimtare e kufirit për luftërat e mundshme, flamuri i përbashkët dhe krijimi i një hapësire unike për qytetarët që i bashkonte liria

dhe dinjiteti njerëzor, pa perde të hekurt në mes, ishin e vetmja rrugë për të nesërmen.

Çelik për të ndërtuar dhe jo për tanke që përdoren kundër njëri-tjetrit, e bënë edhe njërin, edhe tjetrin vend të Europës së Bashkuar më të mirë, më të fortë dhe më të begatë.

9 Maji, dita e Europës është rasti i lumtur për të kuptuar se paqja e fiton gjithmonë luftën!

Ky është mesazhi i madh që jepet sot kur në kufijtë më Lindorë të Europës ka sërish bomba e raketa, tanke dhe tmerr që derdhen mbi një vend sovran, mbi gra e fëmijë dhe mbi luftëtarët e lirisë.

Ata që luftojnë në emër të së drejtës së një kombi për mbijetesë ndaj nazizmit të një udhëheqësi që jeton në të shkuarën, janë rimishërimi i atyre që po në nëntë maj të 77 vjetëve më parë, çliruan njerëzimin nga tragjedia e luftës.

Sot në Ukrainë luftohet për të nesërmen e Europës dhe gjithë botës. Ndaj sot Europa është më e fortë se dje si ide, si zgjedhje dhe zgjidhje.

Ushtarakja me shpirtin narrator, në fluturimin e pakohë

Ilirjana Sulkuqi, oficerë, pedagoge, poete dhe personalitet i shquar, lindi më 5 shtator të viti 1951. Ilirjana, oficerja e karrierës e Forcave të Armatosura, gazetaria model e shtypit ushtarak e më gjerë, poetja e publicistja e shquar, aktivistja e përkushtuar shoqërore dhe e çështjes kombëtare, me krijimtarinë dhe punën e saj të gjithanshme, është një intelektuale dhe personalitet i shquar që ka rrezatuar e rrezaton mirësi, paqe, dashuri, forcë e këmbëngulje për të mos reshtur asnjë çast në të mirë të vetes, familjes, shoqërisë e vendit....

Iliriana Kadri Sulkuqi-Fejzullai, është lindur në qytetin e Elbasanit, më 5 shtator të vitit 1951. Pasi mbaroi gjimnazin "Dhaskal Todri" në qytetin e lindjes (1969), vazhdoi studimet në Akademinë Ushtarake të Forcave Tokësore në Tiranë. Është diplomuar në vitin 1971.

Në vitet 1971-1995, ka qenë oficerë në Akademinë Ushtarake. Më pas, gazetare në shtypin ushtarak dhe në Shtëpinë Botuese të Ushtrisë. Gjatë kësaj periudhe ka mbaruar studimet për gjuhë-letërsi dhe filozofi. Mban gradën nënkolonel. Së fundi ka punuar si gazetare në gazetën "Drita", organ i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë. Aktualisht, jeton në SHBA-New York, (Brooklyn).

Ilirjana Sulkuqi ka këto vlerësime: Më 24 shtator, 2009, në veprimtarinë "Poeteka 2009", është vlerësuar nga Bashkia e Qytetit të Elbasanit, me titullin: "Artist i Shquar i Qytetit", me motivacionin: "Për një kontribut të shquar e cilësor në krijimin e promovimin e vlerave artistike në fushën e poezisë, duke mbetur një qytetare e denjë e qytetit të Elbasanit". Më 13 mars 2018, nga Bashkia e Qytetit të Elbasanit i jepet titulli "Mirënjohja e Qytetit", me motivacionin: "Bijës së Elbasanit për poezinë e saj brilante e në lartësimin e vendlindjes". Qendra e Artit dhe e Kulturës Shqiptare, i jep titullin: "Princ i Artit dhe Kulturës Shqiptare", me motivacionin: "Për kontributin e saj të jashtëzakonshëm si poete, si promovuese e devotshme e kulturës Shqipe. Me lëvrimin e fjalës



së pastër poetike dhe koncepteve të qarta artistike dhe humane, ajo ka lartësuar e ngritur në majat më të larta identitetin e artit dhe letërsisë shqiptare si dhe të autorëve tanë, duke e propaganduar Shqipërinë dhe Kulturën e saj në çdo skaj të botës". Në tetor 2011, Iliriana Sulkuqi është shpallur "Ambasador i Paqes", nga Federata Botërore për Paqen. Në Shkup, në vitin 2016, Iliriana Sulkuqi nderohet me titullin "Nënë Tereza" me motivacionin: "Reflektim i Mirësisë, i Paqes, i Dashurisë, për një kontribut të veçantë në art, Kulturë dhe Humanizëm". Për jetën dhe veprimtarinë e Iliriana Sulkuqit është realizuar një film dokumentar (shqip-anglisht) me autorë: Skenariste: Angjelina Xhara, operator: Ilia Terpini, (Mjeshtër i Madh), regjisor: Kolec Traboini, (Mjeshtër i Madh), reciton poezitë: Margarita Xhepa, "Artiste e Popullit".

Krijimtaria e Ilirjana Sulkuqit:

Ka filluar të shkruajë që në moshë të vogël. Kur ishte 9 vjeç, ka marrë

